



# Riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri

Korrik 2022



## Deanna Davy

Autore, studiuesja kryesore e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) në Shqipëri.

Ky dokument është përgatitur në kuadër të programit *Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria*, zbatuar nga një koalicion i gjashtë organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare: UNICEF Shqipëri, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Prezenca në Shqipëri, Terre des Hommes, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë.

Programi financohet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (MB). Pikëpamjet e shprehura në raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të UNICEF-it ose të pozicioneve të zyrtarëve të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materiale nga ky raport për botimet e tyre. Si mbajtës i së drejtës së autorit, UNICEF Shqipëri kërkon përmendjen e duhur dhe një kopje të botimit.

### **Citim i sugjeruar i raportit:**

Davy, D., *'Riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri. Studim cilësor: Përvojat e të mbijetuarve dhe të profesionistëve mbi aksesin dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për riintegrim ekonomik'*, UNICEF Shqipëri dhe IDRA, 2022.

-----

### **Për informacione të mëtejshme, ju lutem kontaktoni:**

Zyra e UNICEF-it për Shqipërinë  
Godina e UN-it, kati i 3-të, Rr. Skënderbej, Tiranë, Shqipëri  
Telefon: +355 4 45 48 400  
Email: [tirana@unicef.org](mailto:tirana@unicef.org)

# Riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri

Studim cilësor: Përvojat e të mbijetuarve dhe të profesionistëve mbi aksesin dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për riintegrim ekonomik

Korrik 2022





# Pasqyra e lëndës

<b>Lista e akronimeve</b>	<b>6</b>
<b>Falënderime</b>	<b>7</b>
<b>Përmbledhje ekzekutive</b>	<b>8</b>

---

<b>01</b>	<b>Hyrje</b>	<b>14</b>
-----------	--------------	-----------

---

<b>02</b>	<b>Qëllimi dhe objektivat e studimit</b>	<b>19</b>
	Korniza teorike	21

---

<b>03</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>22</b>
	3.1 Qasja metodologjike	23
	3.2 Analiza e të dhënave	26
	3.3 Proceset etike	26

---

<b>04</b>	<b>Kufizimet e Studimit</b>	<b>27</b>
-----------	-----------------------------	-----------

---

<b>05</b>	<b>Gjetjet e studimit</b>	<b>31</b>
	5.1 Mbështetje për trajnim profesional për të mbijetuarit(at) e trafikimit	32
	5.2 Praktikat profesionale dhe mbështetja për punësim	35
	5.3 Hapja e një biznesi	39
	5.4 Shërbime të tjera që mbështesin riintegrimin ekonomik	42
	5.5 Diskutim: Efektet e faktorëve në nivelin individual, të marrëdhënieve, komunitetit dhe shoqërisë mbi riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve	48

---

<b>06</b>	<b>Përfundime dhe hapat pasuese</b>	<b>53</b>
-----------	-------------------------------------	-----------

---

<b>Bibliografia</b>	<b>58</b>
---------------------	-----------

# Lista e akronimeve

LSH	Leku shqiptar
COVID-19	Sëmundja Coronavirus 2019
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
BE	Bashkimi Evropian
GBP	Stërlinga angleze
MF	Mjeku i Familjes
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
IT	Teknologjia e Informacionit
LGBTQI+	Lesbikë, homoseksual, biseksual, transgjinnor, queer dhe interseks
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
OJQ	Organizatë joqeveritare
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
KB	Kombet e Bashkuara
UNICEF	Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara
UNODC	Organizata e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit
MB	Mbretëria e Bashkuar

# Falënderime

Autorja falënderon znj. Elda Denaj dhe z. David Gvineria, si dhe anëtarë të tjerë të ekipit të UNICEF-it, përkatësisht znj. Edina Kozma, znj. Ornela Palushaj, znj. Sonila Pema dhe z. Phenny Kakama për mbështetjen e tyre teknike në procesin e hartimit të këtij raporti. Autorja shpreh gjithashtu mirënjohje për ndihmën e personelit të IDRA Research & Consulting, të cilët zhvilluan intervistat dhe diskutimet në grupet e fokusuara.

Falënderime të singerta shkojnë për anëtarët e grupit të referencës që orientuan procesin e ndërmarrjes së këtij studimi, veçanërisht për znj. Silvana Banushi, Drejtore e Përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, në Ministrinë e Brendshme.

Autorja shpreh më tej mirënjohjen për znj. Harriet Morgan, Oficere e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme, në Ambasadën Britanike në Tiranë, znj. Erjola Foto, Menaxhere e Programit për Fondin e Skllavërisë Moderne për Shqipërinë, në Ambasadën Britanike në Tiranë, dhe znj. Kim Bridger, Shefe e Programit për Luftën kundër Shfrytëzimit, në Ministrinë e Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar.

Një falënderim i veçantë shkon për menaxherët e strehëzave dhe stafin që kanë kryer intervistat me të mbijetuarit(at) e trafikimit për këtë studim. Autorja shpreh mirënjohjen gjithashtu edhe për profesionistët/ofruesit e shërbimeve që morën pjesë në intervista ose diskutime në grupe të fokusuara.

Së fundi, dhe më e rëndësishmja, autorja falënderon të mbijetuarit(at) e trafikimit që ndanë historitë e tyre të lidhura me aksesin në shërbimet e riintegritimit ekonomik, si edhe në shërbime të tjera të rëndësishme riintegrimi në vend.

# Përmbledhje ekzekutive

## Hyrje

Nuk ka një përkufizim të pranuar as në Shqipëri dhe as në nivelin ndërkombëtar për termin “riintegrim ekonomik” i të mbijetuarve të trafikimit. Raportet flasin për “riintegrimin ekonomik” duke iu referuar aktiviteteve kryesore që lidhen me procesin e riintegritimit ekonomik, të tilla si formimi profesional; aksesin në praktika profesionale; aksesin në punësim dhe mundësi sipërmarrjeje; mbështetja financiare; vlerësimet e mjedisit dhe tregut të punës; dhe monitorimi e vlerësimi i riintegritimit ekonomik.<sup>1</sup> Për rrjedhojë, riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve të trafikimit mund të kuptohet si procesi përmes të cilit ata kanë akses në shumë shërbime formimi profesional dhe punësimi, në mënyrë që të jenë ekonomikisht të qëndrueshëm dhe të mos jenë më të rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore.

Riintegrimi i të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri rrjedh nga Plani Kombëtar i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2021–2023. Në vend ka disa kuadre ligjore që përshkruajnë mbështetjen që duhet tu ofrohet të mbijetuarve në fushat e punësimin, shëndetësisë, strehimit dhe ndihmës ekonomike. Pavarësisht pranisë së këtyre kuadreve, literatura mbi këtë fushë sugjeron se ka mangësi dhe sfida lidhur me mbështetjen për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri. Për shembull, Ramaj (2021) thekson sfidat për të mbijetuarit(at) lidhur me aksesin në punësim dhe argumenton se shërbimet e punësimin në Shqipëri kërkojnë kohë dhe i demotivojnë të mbijetuarit(at).<sup>2</sup> Ky studim (raport) synon të japë kontributin e tij për njohuritë bazë në lidhje me riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri, duke ofruar një perspektivë të re mbi këtë temë, një perspektivë që eksploron përvojat e të mbijetuarve dhe profesionistëve lidhur me aksesin ose ofrimin përkatësisht të mbështetjes për riintegrimin ekonomik dhe shërbimeve të tjera të lidhura.

## Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të forcojë të kuptuarit e sfidave me të cilat përballen të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e linjës së parë<sup>3</sup> (ofruesit e shërbimeve që punojnë për agjencitë shtetërore dhe organizatat joqeveritare (OJQ) lidhur me aksesin dhe ofrimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik në Shqipëri.

Objektivat e studimit qëndrojnë sa më poshtë vijon:

- Shqyrtimi dhe dokumentimi i perspektivave të të mbijetuarve dhe profesionistëve në lidhje me mangësitë dhe sfidat lidhur me aksesin ose sigurimin e **mbështetjes cilësore dhe të qëndrueshme** për riintegrimin ekonomik (si formimi profesional, praktikat dhe punësimi).
- Eksplorimi i këtyre sfidave në nivele të ndryshme, përkatësisht ato në nivel **individual, marrëdhëniesh, komuniteti dhe shoqërie**.
- Kuptimi se si shërbimet e tjera (p.sh., **arsimi, kujdesi shëndetësor, strehimi, ndihma ligjore dhe ndihma ekonomike**) veprojnë si pararendës dhe faktorë mbështetës për një mbështetje cilësore dhe të qëndrueshme për riintegrimin ekonomik.
- Identifikimi i mundësive për ofrimin e mbështetjes cilësore dhe të qëndrueshme për riintegrimin ekonomik për të mbijetuarit(at) e trafikimit.

<sup>1</sup> Shih, p.sh., Organizata Ndërkombëtare e Punës, (Riintegrimi social-ekonomik i ish luftëtarëve) [Socio-Economic Reintegration of Ex-Combatants](#). ILO, Gjenevë, 2010, 172 f.; Organizata Ndërkombëtare e Punës, (Udhëzime globale për riintegrimin ekonomik të viktimave të punës së detyruar përmes qasjeve të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit të aftësive) [Global guidelines on the economic reintegration of victims of forced labour through lifelong learning and skills development approaches](#). ILO, Gjenevë, nëntor 2020, f. 106.

<sup>2</sup> Ramaj, Klea, ‘Pasojat e trafikimit të qenieve njerëzore: Eksplorimi i sfidave të kthimit, rehabilitimit dhe riintegritimit të viktimave shqiptare. *Gazeta e Trafikimit të Njerëzve*, 2021, f. 22.

<sup>3</sup> Më tej në këtë raport do të përdoret termi profesionistët e shërbimeve.



## Metodologjia

Metodat e përdorura kanë përfshirë intervista gjysmë të strukturuar dhe diskutime në grupe të fokusuara. Në kuadër të studimit u kryen 14 intervista me të mbijetuarit(at) e trafikimit, 27 intervista të tjera dhe 6 diskutime në grupe të fokusuara me personat me njohuri për çështjen (profesionistët e shërbimeve), përfshirë punonjësit socialë, administratorët e shërbimeve sociale dhe stafin e strehëzave.

Kriteret e përfshirjes në studim janë parashtuar më poshtë:

- Moshë 18 vjeç e lart.
- Shtetas shqiptar i/e trafikuar (jo shtetas të vendeve të huaja).
- Personi të ketë marrë mbështetje për riintegrim ekonomik për të paktën tre muaj.
- Në momentin e intervistës, personi duhet të ketë marrë mbështetje *në një* periudhë të caktuar gjatë dy viteve të fundit.
- Personi duhet të jetë ekzaminuar nga menaxheri i rastit dhe të jetë konstatuar i/e aftë për t'iu përgjigjur pyetjeve të intervistës pa i shkaktuar shqetësime të konsiderueshme.

Vetëm të mbijetuarit(at) e trafikimit që plotësuan kriteret e mësipërme të përfshirjes u ftuan të merrnin pjesë në studim.

**Nga 14 të mbijetuarit(at) e intervistuar, 13 (93%) ishin femra dhe vetëm 1 (7%) ishte mashkull.** Në kohën e intervistës, të mbijetuarit(at) i përkisnin moshës 18-36 vjeç. Të gjithë kishin marrë mbështetje riintegrimi nga një prej strehëzave të menaxhuara nga OJQ-të nga tre muaj deri në katër vjet.

**14 të mbijetuar të intervistuar** moshë 18–36 vjeç



## Gjetjet

### Formimi profesional

Studimi identifikoi se është e rëndësishme që opsionet e formimit profesional të përputhin/korrespondojnë, për aq sa është e mundur, nivelin e arsimit të të mbijetuarve me mundësitë për punësim dhe biznes. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që të mbijetuarit(at) të jenë në gjendje të gjejnë punë të denjë pas përfundimit të trajnimit profesional. Për më tepër, është e rëndësishme që të mbijetuarit(at) të kenë informacion mbi të gjitha opsionet e trajnimit të disponueshme për ta dhe të zgjedhin ato opsione që dëshirojnë të ndjekin, përndryshe, nëse nuk janë të interesuar, ka shumë mundësi që ata të ndërpresin pjesëmarrjen e tyre. Përveç kësaj, studimi identifikoi se formimi profesional duhet të përfshijë edhe përmirësimin e aftësitë e jetës dhe komponentët e menaxhimit të biznesit. Gjithashtu, të mbijetuarit(at) duhet të pajisen me certifikata me përfundimin e formimit profesional, pasi lehtëson rrugëtimin drejt punësimit.

Të intervistuarit për këtë studim theksuan më tej se **shtegu nga formimi profesional drejt punësimit ose hapjes së një biznesi nuk është domosdoshmërisht linear dhe mbështetja për riintegrimin ekonomik nuk duhet të përfundojë në fazën e punësimit**. Të intervistuarit për këtë studim raportuan se **është e rëndësishme që profesionistët e shërbimeve të ofrojnë një cikël të plotë këshillues**, duke i ofruar të mbijetuarve mundësinë për të eksploruar mundësitë që ofron formimi profesional, ndërkohë që gjatë gjithë kohës mbështeten edhe më këshillim.

Të mbijetuarit(at) përballen me shumë sfida të lidhura me aksesin në trajnim cilësor profesional, përfshirë mungesën e aksesit ndaj kujdesit falas për fëmijët, vështirësitë për akses në trajnim profesional në zonat rurale të vendit dhe kohëzgjatjen e shkurtër dhe cilësinë e ulët të disa trajnimeve të ofruara në qendrat e formimit profesional.

### Praktikat profesionale dhe mbështetja për punësim

Studimi identifikoi se **praktikat profesionale** janë një mundësi e vlefshme për të mësuar, e cila duhet t'i paraprijë punësimit për të mbijetuarit(at) që nuk kanë punuar më parë. Studimi më tej identifikoi se **kompanitë që do të punësojnë të mbijetuarit(at) si praktikantë duhet të verifikohen për të garantuar sigurinë e të mbijetuarve**.

Të intervistuarit për këtë studim theksuan se **është e rëndësishme që praktikat të paguhen**. Për të mbijetuarit(at) që nuk kanë punuar më parë, shpërblimi i ndihmon ata të mësohen të marrin pagesa të rregullta nga punëdhënësi i tyre dhe rrit aftësitë e menaxhimit të buxhetit prej tyre, si edhe besimin e përgjithshëm për të hyrë në tregun e punës.

Studimi konstatoi se trajnimet dhe praktikat profesionale e duhura mund të çojnë në punësim të denjë për të mbijetuarit(at) në Shqipëri. **Shtatë të mbijetuar të intervistuar (50%) ishin, në kohën e intervistës, të punësuar në të njëjtën fushë për të cilën ishin trajnuar**: si rrobaqepëse, parukiere, kuzhinierë, mekanik makinash apo profesione të tjera.

Studimi identifikoi disa sfida kryesore për të mbijetuarit(at) në lidhje me gjetjen e punës dhe mbajtjen e saj, duke përfshirë mungesën e mundësive të mira për punë në Shqipëri, mungesën e interesit për punët e disponueshme, mungesën e arsimit, mungesën e kujdesit të përbalueshëm për fëmijët, traumat dhe stigmën e vazhdueshme. Studimi më tej identifikoi se pak të mbijetuar janë të suksesshëm dhe kanë gjetur shpejt një punë pas regjistrimit në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

### Mbështetja për të hapur një biznes

Studimi zbuloi se të hapësh një biznes mund të jetë një përvojë shumë fuqizuese për të mbijetuarit(at). Nëpërmjet proceseve të planifikimit dhe menaxhimit të biznesit, të mbijetuarit(at) mund të përjetojnë rritje të ndjeshme të vetë-besimit. Megjithatë, ata përballen me sfida për hapjen dhe mbajtjen e biznesit të tyre, përfshirë mungesën e njohurive mbi biznesin, pamjaftueshmërinë e kapitalit fillestar dhe praninë e konkurrencës dhe stigmës. Studimi më tej identifikoi se disa nga sfidat që lidhen me fillimin dhe mbajtjen e një biznesi janë unike për të mbijetuarit(at) e trafikimit. Për shembull, ata nuk mund të marrin hua financiare aq lehtësisht sa individët e tjerë, nga frika se borxhi do t'i bëjë ata të cenueshëm ndaj shfrytëzimit dhe ata nuk mund të menaxhojnë një biznes nga shtëpia për arsye sigurie.

## Shërbime të tjera që mbështesin riintegrimin ekonomik

Studimi identifikoi se riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve të trafikimit nëpërmjet formimit profesional, praktikave profesionale, punësimit dhe mbështetjes për të hapur një biznes nuk ndodh veçmas nga shërbimet e tjera mbështetëse. Këto u theksuan në intervistat dhe nga diskutimet në grupet e fokusuar dhe përfshijnë arsimin, kujdesin shëndetësor, strehimin dhe ndihmën ekonomike. Studimi më tej identifikoi se kujdesi falas (i përballeshëm) për fëmijët është një shërbim i rëndësishëm mbështetës.

Mbështetja për arsimin është shumë e rëndësishme për riintegrimin ekonomik. Studimi zbuloi se të mbijetuarit(at) e rinj që mbështeten për të përfunduar shkollën e mesme kanë një shans më të mirë për të gjetur një punë të denjë sesa ata që nuk kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe të mbijetuarit(at) që kanë përfunduar arsimin e lartë (universitar) kanë një shans edhe më të madh për të gjetur punë të denjë profesionale. Megjithatë, ka pengesa që të mbijetuarit(at) të kthehen në shkollën e mesme ose të mendojnë të regjistrohen në arsimin e lartë. Një pengesë është moshë: ata që janë në të njëzetat ose të tridhjetat mund të mendojnë se është tepër vonë që ata të (ri)regjistrohen në shkollën e mesme. Një pengesë tjetër është gjendja e tyre financiare. Të mbijetuarit(at) që jetojnë në komunitet duhet të paguajnë qiranë dhe shërbimet e tjera thelbësore, dhe kështu mund t'i japin përparësi punësimit mbi arsimin.

Kujdesi shëndetësor u identifikua gjithashtu si një shërbim i rëndësishëm që mbështet riintegrimin ekonomik. Të mbijetuarit(at) e intervistuar raportuan se kapërcimi ose menaxhimi i çështjeve mjekësore ishte thelbësor për rimëkëmbjen dhe riintegrimin e tyre të përgjithshëm. Kur të mbijetuarit(at) janë të sëmurë, ata e kanë më të vështirë të gjejnë punë dhe t'i mbajnë ato. Mbështetja për shëndetin mendor është gjithashtu shumë e rëndësishme për riintegrimin ekonomik. Studimi zbuloi se një mbështetje e tillë duhet t'i paraprijë trajnimit profesional dhe aktiviteteve të tjera të riintegrimin ekonomik. Më tej, studimi identifikoi se kjo mbështetje duhet të vazhdojë të ofrohet derisa të mbijetuarit(at) të angazhohen me një punë të re, ose në një biznes të ri. Sfidat kryesore me të cilën përballen të mbijetuarit(at) në Shqipëri për të pasur akses në mbështetjen e shëndetit mendor është mungesa e kujdesit të specializuar për shëndetin mendor, veçanërisht në zonat rurale. Për më tepër, në vend mungon kujdesi shëndetësor i specializuar për të mbijetuarit(at) që vuajnë nga abuzimi me substancat dhe varësitë ndaj tyre.

Mbështetja me strehim u identifikua në studim si kritike për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve. Sipas legjislacionit kombëtar, të mbijetuarit(at) mund të përfitojnë një bonus shtetëror për strehimin dhe, sipas kësaj skeme, ata (krahas të mbijetuarve të dhunës) që janë të punësuar, por kanë të ardhura të kufizuara, mund të marrin një subvencion qiraje prej 50-100 për qind. Megjithatë, studimi konstatoi se shumë pak të mbijetuar janë në gjendje të kenë akses në bonus. Sfidat kryesore janë se të kesh mundësi të marrësh një bonus kërkon paraqitjen e marrëveshjes së qirasë, të cilën pak të mbijetuar e kanë. Një sfidë tjetër është edhe burokracia shtetërore.

Së fundi, të mbijetuarit(at) e trafikimit që janë të papunë dhe kanë një deklaratë nga një profesionist i përshtatshëm i shërbimit që vërteton se ata janë të mbijetuar të trafikimit të qenieve njerëzore, kanë të drejtë të marrin 9,000<sup>4</sup> lekë në muaj ndihmë ekonomike. Megjithatë, studimi identifikoi se pak të mbijetuar e përfitojnë këtë ndihmë ekonomike. Arsyet kryesore janë se kërkesa për ndihmë ekonomike kërkon shumë kohë, sasia e një ndihme të tillë është e ulët dhe të mbijetuarit(at) mund të përballen me diskriminim nga profesionistët e shërbimeve kur aplikojnë për ndihmë.

<sup>4</sup> Leku shqiptar, GBP 62.70 (konvertimi i monedhës më 1 prill 2022).

## Sfidat në nivel individual, të marrëdhënies, komunitetit dhe shoqërisë

Raporti diskuton sfidat me të cilat përballen të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e shërbimeve, përkatësisht lidhur me aksesin ose ofrimin e mbështetjes për riintegrim në nivele të ndryshme - në nivele individuale, marrëdhëniesh, komuniteti dhe shoqërore.

Për sa i përket faktorëve të nivelit individual, raporti thekson se këto **mund të kenë një ndikim të rëndësishëm mbi riintegrimin ekonomik të një të mbijetuarit/e**. Për shembull, shëndeti mendor i tyre mund të ndikojë ndjeshëm në rimëkëmbjen dhe riintegrimin ekonomik.

Faktorët e nivelit të marrëdhënies përqendrohen te mbështetja e familjes së të mbijetuarit(rës). Studimi identifikoi se **të mbijetuarit(at) që kanë një familje mbështetëse janë më mirë të pozicionuar për të (ri)hyrë në studim, punësim ose të hapin një biznes**.

Faktorët e nivelit të komunitetit janë gjithashtu të rëndësishëm në çdo diskutim të riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve. **Një faktor kyç në nivel komuniteti i identifikuar në studim është stigma, e cila mund të zvogëlojë aftësinë e të mbijetuarve për të mbajtur punën ose një biznes të ri dhe për të hyrë në shërbimet shtetërore.**

Në nivel shoqërie, ka një mori faktorësh që mund të pengojnë ose, anasjelltas, të lehtësojnë riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve në Shqipëri. **Faktorët përkatës në këtë nivel përfshijnë proceset burokratike shtetërore që pengojnë aksesin në mbështetjen shtetërore, mungesën e fondeve për shërbimet sociale, mungesën e mundësive për punësim të denjë dhe koordinimin e pamjaftueshëm për referimin në shërbime dhe riintegrimin e të mbijetuarve.**

## Përfundime dhe hapat pasues

Raporti përfundon me sugjerimet e mëposhtme për hapat pasues për forcimin e mbështetjes riintegruese për të mbijetuarit(at) e trafikimit në Shqipëri:

- **Është me vlerë që institucionet e përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore të eksplorojnë opsione për ritjen e pranisë dhe cilësisë së shkollave të formimit profesional dhe qendrave të tjera të trajnimit në zonat rurale të vendit dhe për zgjerimin e programeve të certifikuar të trajnimit** nëpër sektorë që ka të ngjarë të punësojnë të mbijetuar(a).
- Profesionistët e shërbimeve **duhet të sigurojnë që të mbijetuarit(at) të marrin informacion të plotë në lidhje me aftësimin profesional dhe opsionet e punësimit që janë në dispozicion, dhe të fuqizohen të zgjedhin trajnimet dhe punësimin e tyre të preferuar.**
- **Institucionet përkatëse mund të krijojnë dhe të ndajnë bazat e të dhënave të kompanive që ofrojnë punësim për të mbijetuarit(at) si praktikantë.** Ata që shprehin interes për të punësuar të mbijetuarit(at) si praktikantë duhet të verifikohen për të garantuar sigurinë e të mbijetuarve
- Institucionet përkatëse mund të bashkëpunojnë **për të forcuar mekanizmat e trajnimit për vetëpunësimin** e të mbijetuarve. Programet e trajnimit mund të zhvillohen në bashkëpunim me subjektet e sektorit privat; programe të tilla trajnimi mund të ofrojnë njohuri dhe aftësi për rëndësinë e vlerësimeve të tregut, zhvillimin e planeve të biznesit, menaxhimin e buxheteve dhe marketingun. Gjithashtu e rëndësishme është që të mbijetuarve t'u sigurohet **kapitali fillestar** për të mbështetur veten gjatë fazës së hershme të fillimit të biznesit të tyre të ri. Një kapital i tillë fillestar mund të vijë në formën e një kredie me një normë interesi shumë të ulët, ose edhe pa interes.

- **Të mbijetuarit(at) duhet të vazhdojnë të marrin mbështetje për riintegrim nga profesionistët e shërbimeve edhe pasi ata të fillojnë një punë të re, ose të hapin një biznes.** Cikli këshillimor duhet të vazhdojë në periudhë afatgjate, të paktën një vit pas fillimit të punës së re, ose hapjes së një biznesi. Mbështetja për aftësitë e jetës dhe menaxhimin e biznesit duhet të jetë e vazhdueshme, së bashku me këshillimin psikosocial.
- **Ka nevojë për më shumë përpjekje për të forcuar infrastrukturën e arsimit, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe shërbimeve të tjera kyçe sociale, të tilla si kujdesi ndaj fëmijëve.** Kjo kërkon përshkallëzimin e reformave në secilën prej këtyre fushave, të materializuara në rritjen e financimit në nivel vendor për të rritur disponueshmërinë e shërbimeve. Më urgjente është nevoja për forcimin e sistemit të kujdesit ndaj shëndetit mendor në vend.
- Mbështetja për riintegrim ekonomik duhet t'u ofrohet jo vetëm të mbijetuarve, por edhe familjeve të tyre. Një mbështetje e tillë familjare duhet të përfshijë mbështetjen për akses në arsim, kujdes shëndetësor, strehim dhe ndihmë ekonomike dhe duhet të jetë afatgjatë.
- Përpjekjet për të rritur disponueshmërinë e shërbimeve për të mbijetuarit(at) e trafikimit duhet të bëhen në të njëjtën kohë me ato për të ulur qëndrimet negative ndaj të mbijetuarve të trafikimit, edhe mes profesionistëve të shërbimeve. Për të arritur këtë, institucionet e përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore mund **të zhvillojnë një program mbarëkombëtar për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin për trafikimin e qenieve njerëzore** dhe të synojë gjithashtu zvogëlimin qëndrimet diskriminuese ndaj të mbijetuarve.
- **Rritja e përpjekjeve të institucioneve përkatëse dhe sektorit privat për të bashkëpunuar është me vlerë.** Mund të ketë vlerë rishikimi i të gjithë infrastrukturës së koordinimit me qëllim që: të zgjerohet funksioni i Mekanizmit Kombëtar të Referimit për të përfshirë një koordinim më të gjerë të agjencive kundër trafikimit të qenieve njerëzore; të zgjerohen strukturat ekzistuese, të tilla si komitetet rajonale kundër trafikimit, për të koordinuar më mirë aspektet e mbështetjes për riintegrimin e të mbijetuarve, duke përfshirë riintegrimin ekonomik, dhe që të krijohet lidhje me aktorët përkatës të sektorit privat; dhe të futen mekanizma koordinues në nivel bashkie.
- Riintegrimi ekonomik nuk duhet parë i veçuar nga integrimi social. **Ofrimi i shërbimeve brenda kuadreve të integritit ekonomik dhe social duhet të ndërlidhet dhe të përkthehet në ofrim efektiv të shërbimeve.** Për më tepër, ofrimi i shërbimit duhet të jetë i orientuar nga të mbijetuarit(at). Ngritja e kapaciteteve të të gjithë ofruesve të shërbimeve duhet të forcohet, ku të gjithë profesionistët përkatës duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë e ofrimit të shërbimeve të përqendruara te të mbijetuarit(at) dhe rëndësinë e ciklit këshillues për planifikimin e ofrimit të shërbimeve.
- Së fundi, **nevojiten më shumë kërkime për të kuptuar sfidat dhe mundësitë për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit.** Studimet e mundshme mund të përfshijnë: hartëzimin e legjisllacionit kombëtar për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit dhe mënyrën se si legjisllacioni dhe politika përkthehen në praktikë; studime cilësore për të eksploruar se si realizohet riintegrimi ekonomik afatgjatë në kontekstin e Shqipërisë; kërkime cilësore për të trajtuar pyetjet mbi riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve meshkuj dhe atyre lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjjinorë, queer dhe interseks (LGBTQI); mbi sfidat dhe mundësitë për ofrimin e shërbimeve të veçanta mbështetëse, si ndihma juridike; dhe eksplorimi i sfidave specifike me të cilat përballen të mbijetuarit(at) në aksesin e shërbimeve online.



# 1

**Seksioni**

# 1. Hyrje

Riintegrimi i të mbijetuarve të trafikimit kuptohet gjerësisht si procesi përmes të cilit të mbijetuarit(at) janë në gjendje të rivendosin marrëdhëniet sociale dhe psikosociale të nevojshme për të jetuar, për jetesën dhe dinjitetin dhe për përfshirjen në jetën qytetare<sup>5</sup>. Një tipar kryesor i (ri)integritit të suksesshëm është aksesin në një standard cilësor dhe të qëndrueshëm jetese, së bashku me mundësitë për rritje ekonomike. Për shumë të mbijetuar të trafikimit, çështjet ekonomike përbëjnë shqetësimin kryesor gjatë riintegritit.<sup>6</sup> Ndërkohë që nuk ka një përkufizim të pranuar ndërkombëtarisht të termit, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) i referohet riintegritit ekonomik *si procesi përmes së cilit një migrant i kthyer rihyn në jetën ekonomike të vendit të tij ose të saj të origjinës dhe është në gjendje të përballojë jetesën*.<sup>7</sup> Ndërsa ky përkufizim është i dobishëm në kuptimin që thekson se riintegrimi ekonomik është një proces dhe kërkon një jetesë të qëndrueshme, ai nuk merr parasysh aspekte të tjera të rëndësishme, të tilla si trajnimi për aftësim profesional, aksesin në shërbimet e punësimit, mbështetja për hapjen e një biznesi, dhe aksesin në ndihmë ekonomike. Raporte të tjera diskutojnë mbi 'riintegrimin ekonomik' duke iu referuar aktiviteteve kryesore që lidhen me procesin, duke përfshirë aktivitetet e trajnimit profesional, aksesin në praktika profesionale, aksesin në mundësitë për punësim dhe sipërmarrje, mbështetjen gjatë angazhimit në aktivitete të reja jetese, mbështetjen financiare, mjedisin dhe vlerësimet e tregut, dhe monitorimin dhe vlerësimin e riintegritit ekonomik.<sup>8</sup> **Për rrjedhojë, ndërkohë që nuk ka një përkufizim të pranuar ndërkombëtarisht për termin 'riintegrim ekonomik' i të mbijetuarve të trafikimit, ai mund të kuptohet gjerësisht si procesi përmes të cilit të mbijetuarit(at) trajtojnë një sërë shërbimesh formimi profesional dhe punësimi, në mënyrë që të jenë ekonomikisht të qëndrueshëm dhe të mos jenë më në rrezik të trafikimit të qenieve njerëzore.**

Në Shqipëri, nuk ka një përkufizim në nivel kombëtar të «riintegritit ekonomik» të të mbijetuarve të trafikimit. Plani Kombëtar i Veprimit për Riintegrimin Social-Ekonomik të Grave dhe Vajzave Viktima të Trafikimit në Republikën e Shqipërisë<sup>9</sup> i referohet vetëm termit më të gjerë të 'riintegritit' dhe sugjeron këtë përkufizim të termit: 'procesi i përfshirjes dhe rindërtimi i marrëdhënieve brenda një komuniteti në vendin e origjinës në katër nivele: fizik, social-ekonomik, social-politik dhe kulturor.'<sup>10</sup>

Për sa i përket qasjes së politikës kombëtare, Plani Kombëtar i Veprimit përshkruan rëndësinë e riintegritit ekonomik të të mbijetuarve dhe e përqendron qasjen e tij për riintegrimin e të mbijetuarve në katër fusha kryesore. Fusha e parë lidhet me fuqizimin ekonomik të të mbijetuarve, duke përfshirë të drejtat të pronisë, punësimin dhe formimin profesional dhe mbështetjen për mikrondërmarrjet. Fusha e dytë është banimi, e treta ka të bëjë me arsimin dhe e katërta me shërbimet e kujdesit social.<sup>11</sup>

<sup>5</sup> Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, *Glosar i Migracionit*. IOM, Gjenevë, 2019, f.237.

<sup>6</sup> Surtees, Rebecca, ("Ri/integrimi i personave të trafikuar: mbështetja për fuqizimin ekonomik. Punimi me numër 4") ['Re/integration of trafficked persons: supporting economic empowerment. Issue paper No. 4'](#). Fondacioni Mbreti Baudouin, Bruksel, Instituti NEXUS, Uashington, dhjetor 2012, f. 86.

<sup>7</sup> Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, *Glosar i Migracionit*. IOM, Gjenevë, 2019, f. 76.

<sup>8</sup> Shih, për shembull, ILO, 2020, (Udhëzimet globale për riintegrimin ekonomik të viktimave të punës së detyruar përmes qasjeve të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit të aftësive); [Global guidelines on the economic reintegration of victims of forced labour through lifelong learning and skills development approaches](#); ILO, 2010, (Riintegrimi socio-ekonomik i ish-luftëtarëve), [Socio-economic reintegration of ex-combatants](#).

<sup>9</sup> Shih Plani Kombëtar i Veprimit për riintegrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave viktima të trafikimit në Republikën e Shqipërisë, f. 8.

<sup>10</sup> Gazeta Ndërkombëtare e së Drejtës për Refugjatët, 2001, Volumi 13.

<sup>11</sup> Shih Plani Kombëtar i Veprimit për riintegrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave viktima të trafikimit në Republikën e Shqipërisë, f. 13.

Qeveria shqiptare ka zhvilluar politika dhe programe për të mbështetur riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit. Femrat e mbijetuarat të trafikimit janë pjesë e kategorisë së 'grave të papunë' në shërbimet e punësimit.<sup>12</sup> Promovimi i punësimit përfshin mbështetjen e punësimit për punëkërkuesit e marginalizuar (përfshirë të mbijetuarit(at) e trafikimit) për një vit. Kjo mbështetje përfshin pagesën e pagës minimale të të mbijetuarve për gjashtë muaj.<sup>13</sup> Një program tjetër që synon të mbështesë riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit është trajnimi në vendin e punës për punëkërkuesit. Sipas këtij programi, punëkërkuesit marrin 100 për qind të pagës minimale gjatë kohëzgjatjes së katër muajve të trajnimit.<sup>14</sup> Të mbijetuarit(at) e papunë të trafikimit kanë gjithashtu të drejtën të regjistrohen si punëkërkues pranë Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (AKPA), e cila është agjencia qeveritare përgjegjëse për të ndihmuar qytetarët shqiptarë që kërkojnë punë. Zyrat e AKPA-së supozohet t'u japin përparësi punëkërkuesve nga grupet e cenueshme, përfshirë viktimat e trafikimit. Sipas Raportit të Trafikimit të Personave të Shteteve të Bashkuara të vitit 2021, gjatë periudhës të raportimit (viti 2020) janë regjistruar 60 të mbijetuar(a) të trafikimit në AKPA për mundësi punësimi.<sup>15</sup>

Për më tepër, në bazë të Ligjit 65/2016 për sipërmarrjet sociale, të mbijetuarit(at) e trafikimit, përbëjnë një prej grupeve kryesore përfituese, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 56/2018 'Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara'. Në bazë të këtij ligji, të paktën 30 për qind të të punësuarve që i përkasin grupeve të marginalizuara dhe të mbijetuarve të trafikuar (kryesisht gra dhe vajza) duhet t'u jepet mbështetje e veçantë për të pasur akses në tregun e punës.

Të mbijetuarit(at) e trafikimit mund të kenë akses në trajnime profesionale pa pagesë në shkollat profesionale në të gjithë Shqipërinë. Aktualisht ekzistojnë 50 shkolla profesionale teknike (41 publike dhe 9 private) dhe 10 qendra publike formimi profesional, kryesisht në zona urbane. Ato janë të pranishme thuajse në të gjitha qarqet, me përqendrim më të madh në Shqipërinë e mesme. Gjithësej ekzistojnë rreth 340 biznese private ose ofrues trajnimi të licensuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe 30 që funksionojnë si qendra formimi profesional.<sup>16</sup>

Gjatë viteve të fundit, të mbijetuarit(at) e trafikimit në Shqipëri kanë pasur gjithashtu të drejtë të përfitojnë ndihmë financiare nga shteti në masën 3,000 lek<sup>17</sup> në muaj sipas legjislacionit shqiptar, e njohur si 'ndihmë ekonomike'. Që nga fillimi i vitit 2022, kjo shumë u rrit në 9,000 lek në muaj.<sup>18</sup> Bazuar në të njëjtin ligj, mundësia e dhënies së mbështetjes financiare për të mbijetuarit(at) e trafikimit i jepet gjithashtu bashkive.

Të mbijetuarit(at) e trafikimit të qenieve njerëzore përbëjnë gjithashtu një grup përparësie sipas Ligjit nr. 22/18 sa i takon strehimit social. Si pasojë e këtij legjislacioni, janë krijuar programe për të mbështetur personat e cenueshëm, përfshirë edhe një program për strehim të veçantë për të mbijetuarit(at) e trafikimit, të cilët gjithashtu kanë të drejtën të marrin një bonus për strehim nga shteti. Ky mekanizëm u lejon të mbijetuarve të trafikimit, të cilët janë të punësuar, por kanë të

<sup>12</sup> Ligji 15/2019 'Për nxitjen e punësimit'. Neni 4 i njej viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore si grupe të marginalizuara dhe se kanë të drejtë për mbështetje shtesë.

<sup>13</sup> VKM nr. 17, 2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregulloret për zbatimin e nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, trajnimit në punë dhe praktikave profesionale".

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, 2021, (Raporti i Trafikimit të Personave 2021: Shqipëria), [Trafficking in persons report 2021: Albania](#).

<sup>16</sup> Të ndryshëm dhe të barabartë, 2018, Kërkim mbi aftësitë dhe mundësitë e tregut lokal të punës për të mbështetur fuqizimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit dhe dhunës në familje në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë.

<sup>17</sup> Leku shqiptar, GBP 20.90 (konvertimi i monedhës më 1 prill 2022).

<sup>18</sup> GBP 62.70 (konvertimi i monedhës më 1 prill 2022). Informacioni është marrë nga intervistat me përfaqësues të qeverisë dhe OJQ-ve dhe pjesëmarrësit në diskutime në grupe të fokusuar. Ligji 57/2019 'Për ndihmën sociale' neni 7 VKM nr. 597/2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe pagesës mujore të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondeve shtesë të kushtëzuara për ndihmën ekonomike".



ardhura të kufizuara, të marrin ose 50 përqind ose 100 përqind të subvencionimit të qirasë, në varësi të nivelit të të ardhurave të tyre dhe numrit të fëmijëve.<sup>19</sup>

Qeveria e Shqipërisë aktualisht menaxhon një strehëz të specializuar për të mbijetuarit(at) e trafikimit dhe mbështet tre strehëza të specializuara të menaxhuara nga OJQ-të.<sup>20</sup> Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat e Trafikimit (strehëz e menaxhuar nga qeveria) dhe tre strehëzat e tjera të menaxhuara nga OJQ-të<sup>21</sup> ofrojnë shërbime të ndryshme rehabilitimi dhe riintegrimi, përfshirë arsimin, trajnimin profesional, mentorimin për punësim dhe shërbime për fuqizimin ekonomik.<sup>22</sup>

Literatura e disponueshme sugjeron se, pavarësisht këtyre politikave, ka ende mangësi dhe sfida lidhur me mbështetjen e riintegritit ekonomik në Shqipëri për të mbijetuarit(at) e trafikimit dhe shumë nga këto sfida janë në nivelin e shoqërisë. Për shembull, Tahiraj (2017) sugjeron se ndërsa mbështetja për të mbijetuarit(at) e trafikimit shqiptarë për punësim është e disponueshme për të papunët e regjistruar, shanset e tyre për të gjetur punë fitimprurëse në Shqipëri janë të ulëta.<sup>23</sup> Studiuesit argumentojnë se shanset që një person i trafikuar të gjejë punë nuk mund të priten të jetë më të larta se sa për personat e tjerë të papunë.<sup>24</sup> Ramaj (2021) gjithashtu thekson sfidat për të mbijetuarit(at) lidhur me aksesin në punësim. Të mbijetuarit(at) e papunë të trafikimit kanë të drejtë të regjistrohen si punëkërkuar në AKPA. Megjithatë, shumica e profesionistëve të shërbimeve që Ramaj intervistoi raportuan se aksesin në shërbim është një proces që kërkon kohë dhe demotivues për të mbijetuarit(at) e trafikimit. Të mbijetuarit(at) thuhet se presin disa muaj që dokumentet e tyre të përpunohen, dhe më pas shpesh për muaj të tjerë derisa të mund të gjejnë një punë. Kjo çon në paqëndrueshmëri financiare dhe tjetëron çdo përfitim të shëndetit mendor.<sup>25</sup> Ramaj më tej argumenton se riintegrimi afatgjatë i të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri ndikohet negativisht nga mungesa e qëndrueshmërisë ekonomike dhe kushtet shfrytëzuese të punës.<sup>26</sup> Shumica e profesionistëve të shërbimeve të intervistuar për studimin e Ramajt deklaruan se, për të mbijetuarit(at) e trafikimit, ndërtimi i një stili jetese të shëndetshme lidhet shumë me qëndrueshmërinë financiare. Megjithatë, punësimi është shpesh i paqëndrueshëm për shkak të faktorëve që lidhen me mungesën e gatishmërisë së punëdhënësve për të mbështetur zhvillimin profesional të të mbijetuarve ose natyrën sporadike të bizneseve private ku ata mund të gjejnë punë.<sup>27</sup> Sipas profesionistëve të shërbimeve të intervistuar për studimin e Ramajt, të mbijetuarit(at) e trafikimit janë të punësuar kryesisht si punëtorë krahu në punishte me kushte të këqija pune.<sup>28</sup>

Ndërsa literatura e disponueshme jep informacion të dobishëm mbi kuadrin ligjor dhe të politikave për riintegrimin ekonomik në Shqipëri, mbeten ende mangësi të konsiderueshme njohurish në lidhje me përvojat dhe sfidat me të cilat përballen të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e shërbimeve sa i takon përkatësisht aksesit ose ofrimit të mbështetjes për riintegrimin ekonomik. Ndërsa ligje

<sup>19</sup>. Informacioni i marrë nga intervistat me përfaqësuesit e qeverisë dhe OJQ-ve dhe pjesëmarrësit në diskutime në grupe të fokusuara.

<sup>20</sup>. Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, 2021, (Raporti i Trafikimit të Personave 2021: Shqipëria), [Trafficking in persons report 2021: Albania](#).

<sup>21</sup>. Të ndryshëm dhe të barabartë, Tjetër Vizion, Qendra Psiko-Sociale 'Vatra'

<sup>22</sup>. Grupi i Ekspertëve për Veprimin Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 'Raporti i Vlerësimit: Shqipëri. Raundi i tretë i vlerësimit: Qasja në drejtësi dhe mjete efektive juridike për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. [Evaluation report: Albania. Third evaluation round: Access to justice and effective remedies for victims of trafficking in human beings](#). GRETA, dhjetor 2020, f. 48.

<sup>23</sup>. Tahiraj, Enkelejda, "Kuptimi i trafikimit të vajzave dhe grave nga Shqipëria" Programi Shpresa, korrik 2017.

<sup>24</sup>. Po aty.

<sup>25</sup>. Ramaj, Klea, "Pasojat e trafikimit të qenieve njerëzore: Eksplorimi i sfidave të kthimit, rehabilitimit dhe riintegritit të viktimave shqiptare. *Gazeta e Trafikimit të Njerëzve*, 2021, f. 22.

<sup>26</sup>. Po aty.

<sup>27</sup>. Po aty.

<sup>28</sup>. Po aty.

dhe politika të ndryshme përshkruajnë të drejtat e të mbijetuarve të trafikimit për mbështetje për riintegrimin ekonomik, në literaturë thuhet pak nëse të mbijetuarit(at) janë në gjendje të kenë lehtësisht akses në këto dispozita mbështetëse. Më tej, pak kuptohet, nga këndvështrimi i të mbijetuarve, nëse mbështetja ku ata kanë akses është cilësore dhe e qëndrueshme. Ekziston gjithashtu një kuptim i kufizuar se si faktorët në nivele të ndryshme (d.m.th., në nivel individual, marrëdhënieje, komuniteti dhe shoqërie) kanë ndikim negativ mbi aftësinë e të mbijetuarve për të pasur akses në mbështetje cilësore dhe të qëndrueshme të riintegritit ekonomik.

Ky studim trajton mangësi të rëndësishme në njohuri në lidhje me sfidat që lidhen me aksesin dhe sigurimin e riintegritit ekonomik, nga këndvështrimi i profesionistëve të shërbimeve, përfaqësuesve të organizatave të sektorit privat dhe të mbijetuarve të trafikimit. Ai përfaqëson një nga përpjekjet e para për të eksploruar në thellësi temën e sfidave për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri. Përmirësimi i të kuptuarit të mangësive, sfidave, rreziqeve dhe mundësive për mbështetjen e riintegritit ekonomik do t'i pajisë agjencitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të në Shqipëri me informacion të rëndësishëm për forcimin e ofrimit të mbështetjes për riintegrimin ekonomik dhe, për rrjedhojë, do të zvogëlojë cenueshmërinë ndaj (ri)trafikimit.

Raporti është strukturuar si më poshtë:

### **Hyrja,**

**Seksioni 2** paraqet qëllimin dhe objektivat e studimit,

**Seksioni 3** eksploron metodologjinë e studimit,

**Seksioni 4** diskuton kufizimet e studimit, dhe


**Seksioni 5** raporton gjetjet, duke përfshirë sfidat e lidhura me aksesin ose ofrimin e mbështetjes në fushat e formimit profesional, praktikave profesionale, mundësive të punësimit dhe nisjes së një biznesi të ri, si dhe shërbime të tjera përkatëse.

**Seksioni i gjetjeve** gjithashtu eksploron sesi faktorët në nivele të ndryshme, për shembull, në nivel individual, marrëdhënieje, komuniteti dhe shoqërie, lehtësojnë ose pengojnë riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve.

Raporti përfundon me **një përmbledhje të pikave kryesore dhe me sugjerime** për hapat e ardhshëm për forcimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik për të mbijetuarit e trafikimit në Shqipëri.

# 2

**Seksioni**



## 2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të forcojë të kuptuarit e sfidave me të cilat përballen të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e shërbimeve, përkatësisht lidhur me aksesin ose ofrimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik në Shqipëri. Duhet të theksohet se studimi nuk synon të krahasojë shërbimet e riintegrimit ekonomik të qeverisë dhe OJQ-ve për të mbijetuarit(at) e trafikimit.

Më konkretisht, objektivat e studimit janë:

- Shqyrtimi dhe dokumentimi i perspektivave të të mbijetuarve dhe profesionistëve të shërbimeve (të punësuar në agjencitë shtetërore dhe OJQ-të) në lidhje me mangësitë dhe sfidat për aksesin dhe ofrimin e mbështetjes **cilësore dhe të qëndrueshme** për riintegrimin ekonomik (p.sh. formimi profesional, praktikat dhe punësimi).
- Eksplorimi i këtyre sfidave në nivele të ndryshme, domethënë në nivel të **individit, marrëdhënieve, komunitetit dhe shoqërisë**.
- Kuptimi se si shërbimet e tjera (p.sh., **arsimi, kujdesi shëndetësor, ndihma ligjore për strehimin dhe ndihma ekonomike**) veprojnë si pararendës dhe faktorë të rëndësishëm për një mbështetje cilësore dhe të qëndrueshme për riintegrimin ekonomik.
- Identifikimi i mundësive për ofrimin e mbështetjes cilësore dhe të qëndrueshme për riintegrimin ekonomik për të mbijetuarit(at) e trafikimit.

Në pajtim me objektivat e përmendura më sipër, studimi synon t'i përgjigjet pyetjeve të mëposhtëme kërkimore:

- Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen të mbijetuarit(at) lidhur me aksesin në shërbime cilësore dhe të qëndrueshme të riintegrimit ekonomik, si dhe në ruajtjen e mjeteve të jetesës?
- Si i lehtësojnë ose pengojnë faktorët në nivelin individual, të marrëdhënieve, të komunitetit, të shoqërisë aksesin e të mbijetuarve në shërbime cilësore dhe të qëndrueshme të riintegrimit ekonomik?
- Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore për profesionistët e shërbimeve lidhur me ofrimin e mbështetjes cilësore dhe të qëndrueshme për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit?
- Si veprojnë shërbimet e tjera, të tilla si arsimi, kujdesi shëndetësor, strehimi, ndihma ligjore dhe ndihma ekonomike si pararendës dhe faktorë mbështetës për një mbështetje cilësore dhe të qëndrueshme për riintegrimin ekonomik?
- Cilat janë perspektivat e profesionistëve dhe të të mbijetuarve për mekanizmat për forcimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik për të mbijetuarit e trafikimit në Shqipëri?

Studimi kishte një perspektivë largpamëse në drejtim të identifikimit të fushave kyçe për ndërhyrje të ardhshme për mbështetjen e riintegrimit ekonomik në Shqipëri. Studimi synon gjithashtu të identifikojë mangësitë e vazhdueshme në njohuri që mund të trajtohen përmes studimeve të ardhshme. Qëllimi, objektivat dhe pyetjet e studimit u informuan nga analiza e literaturës e kryer në fazën e hartimit të studimit. Studiuësja kryesore mblodhi dhe analizoi literaturën e fundit akademike të kufizuar dhe literaturën gri mbi temën e mbështetjes së riintegrimit ekonomik për të mbijetuarit(at) e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, veçanërisht atë mbi sfidat dhe mundësitë për të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e shërbimeve për aksesin dhe sigurimin, në përputhje me rrethanat, të mbështetjes për riintegrim ekonomik. Qëllimi dhe objektivat e studimit u përmirësuan më tej në fazën fillestare përmes konsultimeve me aktorët përkatës, duke përfshirë stafin e UNICEF-it në Shqipëri, disa OJQ

kombëtare kundër trafikimit, një ekspert kombëtar antitrafik, IDRA Research & Consulting, dhe Grupin e Referencës për studimim, i cili angazhon autoritetin kombëtar qeveritar kundër trafikimit. Projekt-raporti iu nënshtrua të njëjtave shtresave të analizës.

## 2.1 Korniza teorike

Të dhënat u analizuan duke përdorur teorinë ekologjike të punës sociale si kornizë për interpretimin e rezultateve. Ndërkohë që ky studim synon të forcojë kuptimin tonë të sistemit aktual për mbështetjen e riintegritimit ekonomik që u ofrohet të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri, si dhe mangësitë dhe sfidat e ndryshme me të cilat hasin të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e shërbimeve lidhur me aksesin ose ofrimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik, kuptimi i aktiviteteve të profesionistëve të shërbimeve dhe sfidave në nivele të ndryshme u konsideruan të dobishme për interpretimin e të dhënave cilësore të mbledhura përmes intervistave dhe diskutimeve në grupet e fokusuara (DGF).

Siç theksohet nga Cecchet dhe Thoburn (2014), të mbijetuarit(at) e trafikimit kanë nevojë për plane mbështetëse të bazuara në qasje gjithëpërfshirëse të sistemit ekologjik, në mënyrë që të ofrojnë mbështetjen dhe shërbimet e nevojshme pas shpëtimit të tyre nga shfrytëzimi.<sup>29</sup> **Mjedisi ekologjik përbëhet nga katër nivele të ndryshme sistemesh të rregulluara si një strukturë e ndërthurur: niveli individual (p.sh., qëndrimet, sjelljet, shëndeti, historia sociale), marrëdhëniet (varfëria, papunësia), niveli i komunitetit (aksesi në shërbimet lokale) dhe niveli i shoqërisë (politikat kombëtare dhe lokale).** Duke marrë parasysh këto nivele të ndryshme, modeli ekologjik ofron një qasje me shumë shtresa të punës sociale dhe promovon një plan veprimi për kurimin dhe rimëkëmbjen e të mbijetuarve.<sup>30</sup>

Perspektiva ekologjike ofron një kornizë të dobishme për të kuptuar nevojat për mbështetje të të mbijetuarve të shpëtuar të trafikimit dhe aktivitetet e profesionistëve të shërbimeve që ofrojnë shërbime për të mbijetuarit(at), pasi kërkon **të analizojë strukturat e partneritetit dhe të risë mirëkuptimin dhe koordinimin midis partnerëve të rrjetit të ofruesve të shërbimeve dhe midis të mbijetuarve dhe profesionistëve të shërbimeve.** Në qendër të perspektivës ekologjike janë **profesionistët e shërbimeve, të cilët ulen në një pozicion strategjik për të vëzhguar, koordinuar dhe përmirësuar ofrimin e shërbimeve të thjeshta për të mbijetuarit(at) e trafikimit.** Nga ky pozicion strategjik, **profesionistët e shërbimeve janë në gjendje të shohin se si përvojat dhe nevojat e një të mbijetuarit mund të ndikohen nga sistemi i drejtësisë penale, profesionistët e shërbimeve dhe agjencitë dhe individët e tjerë, dhe më pas të planifikojnë dhe menaxhojnë ngjarje të tilla.**<sup>31</sup>

Perspektiva ekologjike u përdor si një instrument për këtë studimim për të eksploruar, ndër të tjera, elementët e ndryshëm të mbështetjes së riintegritimit ekonomik në dispozicion të të mbijetuarve të trafikimit, natyrën jolineare të mbështetjes së riintegritimit, rolin kryesor të profesionistëve të shërbimeve për mbështetjen e riintegritimit ekonomik të të mbijetuarve dhe sfidat me të cilat përballen profesionistët e shërbimeve për ofrimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik për të mbijetuarit(at) e trafikimit. Së fundi, modeli lejon eksplorimin e sfidave me të cilat përballen të mbijetuarit(at) lidhur me aksesin në shërbimet e riintegritimit ekonomik në nivele të ndryshme (në nivelin individual, në nivel të marrëdhënieve, në nivel komuniteti dhe në nivel shoqërie).

<sup>29</sup> Cecchet, Stacy J., dhe John Thoburn, ("Përvoja psikologjike e trafikimit seksual të fëmijëve dhe adoleshentëve në Shtetet e Bashkuara: Trauma dhe qëndrueshmëria tek të mbijetuarit" ('[The psychological experience of child and adolescent sex trafficking in the United States: Trauma and resilience in survivors](#)'). *Trauma Psikologjike: Teori, Hulumtim, Praktikë dhe Politika*, vol. 6 nr. 5, 2014, f. 482–493.

<sup>30</sup> Sanchez, Rosario V., dhe Dula Pacquiao, (Një përjasje ekologjike drejt parandalimit dhe kujdesit ndaj viktimave të trafikimit të seksit ndaj të miturve në familje"). '[An Ecological Approach toward the Prevention and Care of Victims of Domestic Minor Sex Trafficking](#)'. *Revista e Infermierisë Ligjore*, vol. 14 nr. 2, 2018, f. 98–105.

<sup>31</sup> Pardeck, John, "Një qasje ekologjike për praktikën e punës sociale". *Revista e Sociologjisë dhe Mirëqenies Sociale*, vëll. 15 nr. 2, 1998, fq. 133–142; Beyer, Kirsten, Wallis, Anne B. dhe Hamberger, L. Kevin, "Mjedisi i lagjes dhe dhuna e partnerit intim: një rishikim sistematik". *Trauma, Dhuna dhe Abuzimi*, vëll. 16 nr. 1, Epub dhjetor 2013, f. 16–47.

# 3

**Seksioni**



## 3. Metodologjia

### 3.1 Qasja metodologjike

Studimi përdori një qasje cilësore. Studiuesja kryesore, në konsultim me UNICEF-in në Shqipëri dhe aktorët e ndryshëm të përmendur më sipër<sup>32</sup>, ranë dakord se një qasje e tillë ishte më e përshtatshme për të mundësuar eksplorimin e thellë të sfidave për të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e shërbimeve lidhur me aksesin ose ofrimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik në Shqipëri. Intervistat gjysmë të strukturuar dhe DGF-të me profesionistë të shërbimeve **të punësuar brenda agjencive qeveritare dhe OJQ-ve, dhe intervistat me përfaqësues të sektorit privat dhe me të mbijetuarit(at) e trafikimit**, lejuan mbledhjen e narrativave të thelluara dhe të të dhënave të pasura për t'u përdorur për analizë dhe për shkrimin e raporteve.

#### Metodat

Metodat cilësore të përdorura për studimin përfshinë intervista gjysmë të strukturuar me të mbijetuarit(at) e trafikimit dhe profesionistët (profesionistët e shërbimeve **që punojnë në qeveri, OJQ-të dhe përfaqësuesit e sektorit privat**), këto të fundit nëpërmjet intervistave individuale ose në diskutime në grupe të fokusuar. Këto burime të ndryshme të të dhënave shërbyen për të plotësuar dhe të sjellë së bashku gjetjet nga grupet e ndryshme të të dhënave. Vetëm të mbijetuarit(at) e trafikimit që **përbushën** kriteret e përfshirjes (shih më poshtë) u ftuan për intervistë për këtë studim. Për të rekrutuar të **intervistuarit për këtë studim** dhe pjesëmarrësit në diskutime në grupe të fokusuar, u përdorën metodat e kampionimit të përshtatshëm<sup>33</sup> dhe metoda e topave të borës.

Të gjitha mbledhjet e të dhënave u kryen gjatë periudhës 14 tetor 2021 deri më 7 shkurt 2022. Përpara mbledhjes së të dhënave për kërkimin, ekipi monitoroi me kujdes situatën e sëmundjes Coronavirus 2019 (COVID-19). Mbledhja e të dhënave filloi vetëm kur ekipi kërkimor ra dakord se ishte e sigurt, për pjesëmarrësit e studimit, intervistuesit dhe lehtësuesit, të kryenin intervista dhe DGF.

#### Intervistat gjysmë të strukturuar me të mbijetuarit(at) e trafikimit

Në kuadër të studimit u organizuan katërmbëdhjetë intervista ballë për ballë gjysmë të strukturuar me të mbijetuarit(at) e trafikimit. Procesi i organizimit dhe realizimit të intervistave u krye duke përdorur qasjen e **përqendruar te të mbijetuarit(at)**. U morën të gjitha masat për të siguruar që të mbijetuarit(at) **të merrnin një shpjegim të plotë të studimit nga strehëza**<sup>34</sup> **që i mbështeste** ata, që ata i kuptonin pyetjet e intervistës dhe arsyet pse bëheshin ato, si do të përdroreshin të dhënat e tyre dhe kush do t'i kryente intervistat (një studiues i kualifikuar shqiptar). Përpara intervistave të para me të mbijetuarit(at), profesionistët përkatës të shërbimeve dhe intervistuesit morën pjesë në një sesion trajnimi gjysmë-ditor me studiuesen kryesore dhe stafin e UNICEF-it në Shqipëri, të cilët shpjeguan proceset etike për rekrutimin e pjesëmarrësve, intervistimin dhe menaxhimin e të dhënave.<sup>35</sup>

<sup>32</sup> Shiko seksionin 2 të raportit

<sup>33</sup> Mostra e përshtatshme është një lloj kampionimi pa probabilitet në të cilin njerëzit përfshihen në një studim thjesht sepse janë burime 'të përshtatshme' të të dhënave. Në rastin e këtij studimi, personat me njohuri mbi çështjen që mund t'i përgjigjeshin pyetjeve të intervistës, dhe të gjithë të mbijetuarit që plotësonin kriteret e përfshirjes, u ftuan të merrnin pjesë në studim.

<sup>34</sup> Të ndryshëm dhe të barabartë, Tjetër Vizion, Qendra Psikosociale 'Vatra' dhe Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit.

<sup>35</sup> Për më shumë informacion, shihni seksionin e raportit mbi proceset etike.

Për këtë studim u zbatuan kriteret për rekrutimin dhe pjesëmarrjen e të mbijetuarve të trafikimit në intervista. Kriteret për pjesëmarrësit përfshinin:

1	2	3	4	5
Mosha <b>18 vjeç e lart.</b>	<b>Shtetas shqiptar i/e trafikuar</b>	Personi të ketë <b>marrë mbështetje për riintegrim ekonomik</b> për të paktën tre muaj.	Në momentin e intervistës, personi të ketë marrë <b>mbështetje në çdo kohë gjatë dy viteve të fundit.</b>	Personi të ishte <b>ekzaminuar nga menaxheri i rastit</b> dhe të ishte konstatuar i aftë për t'iu përgjigjur pyetjeve të intervistës pa i shkaktuar shqetësime të konsiderueshme.

Vetëm ata të mbijetuar që plotësonin të gjitha kriteret e përfshirjes u kontaktuan nga punonjësi i tyre social për të diskutuar nëse ishin të interesuar për të marrë pjesë në studim.

Pyetjet e intervistës së të mbijetuarve u rishikuan nga të gjithë aktorët përkatës<sup>36</sup> në fazën fillestare të studimit. Staf i strehëzës shqyrtoi dhe dha komente mbi pyetjet (në gjuhën shqipe), të cilat u rishikuan sërish pas dy intervistave të para të kryera me të mbijetuarit(at) e trafikimit.

Qëllimi i intervistimit të të mbijetuarve të trafikimit ishte të eksploronte, nga këndvështrimi i tyre, sfidat me të cilat ata përballen sa i takon aksesit në mbështetje cilësore dhe të qëndrueshme të riintegritit ekonomik, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në, trajnimin profesional, praktikat, shërbimet e punësimit dhe mbështetjen për të filluar një biznes të ri. Intervistat synonin të eksploronin përvojat e të mbijetuarve lidhur me aksesin në këto dhe shërbime të tjera të rëndësishme (të tilla si arsimiti, kujdesi shëndetësor, duke përfshirë mbështetjen e shëndetit mendor, strehimin dhe ndihmën ekonomike), dhe perspektivat e tyre mbi mangësitë, pikat kryesore dhe mundësitë për mbështetjen e riintegritit ekonomik për të mbijetuarit(at) e trafikimit në Shqipëri.

Pas përfundimit të çdo interviste, regjistrimet në audio dhe shënimet e intervistës u ruajtën në mënyrë të sigurt në një kompjuter të mbrojtur me fjalëkalim. Intervistuesi ishte përgjegjës për transkriptimin e intervistave dhe heqjen e çdo informacioni identifikues që mund të ishte dhënë vullnetarisht nga të mbijetuarit(at). Përkthimi i transkripteve të intervistës së të mbijetuarve u bë nga një kompani përkthimi e verifikuar që UNICEF-i kishte përdorur më parë për studime të tjera të ndjeshme. Intervistuesi ishte përgjegjës për kontrollimin e transkripteve të përkthyera për saktësinë e gjuhës.

### Profili i pjesëmarrësve në intervistat e të mbijetuarve

**Nga 14 të mbijetuar të intervistuar, 13 (93%) ishin femra dhe 1 (7%) ishte mashkull.** Vetëm një (7%) e mbijetuar u identifikua se i përket një pakice etnike. **Në kohën e intervistës, të mbijetuarit(at) ishin të moshës 18-36 vjeç. Të mbijetuarit(at) kishin marrë mbështetje për riintegrim nga një prej strehëzave për tre muaj deri në katër vjet.** Pjesa më e madhe e tyre, por jo të gjithë, ishin ende të akomoduar në një strehëz **në kohën e intervistës.** Në kohën e intervistës, nga 14 të mbijetuarit(at), dy (14%) ishin të regjistruar në programe diplomash universitare, katër (28%) ishin në shkollë të mesme, tre (21%)

<sup>36</sup> Staf i UNICEF-it në Shqipëri, disa OJF, përfshirë punonjës social, një ekspert kombëtar anti trafik, kompanie e kërkimit IDRA, dhe grupi i referencës së studimit.



kishin përfunduar shkollën e mesme, dy (14%) kishin përfunduar arsimin bazë (9-vjeçar) dhe dy (14%) nuk kishin përfunduar arsimin bazë.

### *Intervistat gjysmë të strukturuar me profesionistët*

U realizuan njëzet e shtatë intervista gjysmë të strukturuar me pjesëmarrje fizike me profesionistët **për këtë studim** të punësuar në agjencitë qeveritare dhe OJQ-të në Shqipëri. Njëzet e një intervista u kryen me përfaqësues të qeverisë që punojnë në nivel qarku ose bashkie, dhe me persona të punësuar në shërbimet shëndetësore shtetërore dhe strehëzën shtetërore për të mbijetuarit(at) e trafikimit (Qendra Kombëtare e Akomodimit për Viktimat e Trafikimit). Katër intervista u kryen me punonjës të OJQ-ve në strehëza dhe dy u kryen me përfaqësues të organizatave të sektorit privat që punësojnë të mbijetuarit(at) e trafikimit. Intervistat u kryen nga një studiues shqiptar i kualifikuar dhe me përvojë.<sup>37</sup>

Intervistat me të gjithë pjesëmarrësit në **këtë studim** u organizuan nga IDRA, e cila përzgjedhi agjencitë shtetërore, OJQ-të dhe organizatat e sektorit privat më të rëndësishme të përfshira në riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit dhe iu drejtua atyre agjencive për intervista. Agjencitë u zgjodhën në bazë të aktiviteteve të tyre të riintegrimin ekonomik dhe aftësisë së pritshme të përfaqësuesve të tyre për të diskutuar pyetjet e kërkimit të studimit. U bënë përpjekje për të siguruar që të kishte një ekuilibër në intervistat me subjektet shtetërore dhe joshtetërore dhe ato me përfaqësues të lartë institucionesh (p.sh., drejtorë) dhe profesionistë të shërbimeve. Megjithatë, siç u theksua më sipër, vetëm dy intervista u organizuan me organizatat përkatëse të sektorit privat. Ndërsa më pak intervista u kryen me përfaqësues të OJQ-ve sesa me agjencitë shtetërore, përfaqësuesit e OJQ-ve morën pjesë gjithashtu në diskutime në grupe të fokusuara.

Qëllimi i intervistave ishte të eksploronin, nga këndvështrimi i profesionistëve të shërbimeve **që ofrojnë mbështetje për riintegrimin ekonomik për të** mbijetuarit(at) e trafikimit, sfidat me të cilat përballen për ofrimin e mbështetjes cilësore dhe të qëndrueshme. Intervistat u përdorën më tej për të lidhur gjetjet nga intervistat me të mbijetuarit(at).

Pyetjet kryesore të intervistave me këta persona u testuan në një grup të vogël të personave me njohuri mbi çështjen dhe u bënë ndryshimet përkatëse në pyetësorë përpara se të kryeshin intervistat me pjesën tjetër të personave me njohuri mbi çështjen.

Pas përfundimit të secilës prej intervistave, intervistuesi ishte përgjegjës për transkriptimin e intervistës dhe heqjen e çdo informacioni identifikues përpara se t'i **përcillte transkriptet** për përkthim.

### *Diskutimet në grupe të fokusuara*

Në kuadër të studimit u organizuan gjashtë diskutime në grupe të fokusuara me pjesëmarrjen fizike të 22 përfaqësuesve të agjencive përkatëse qeveritare dhe OJQ-ve në Shqipëri. Këta pjesëmarrës përfshinin punonjës socialë (staf i qeverisë dhe OJF-ve), administratorë të shërbimeve sociale (qeveria) dhe staf të strehëzave (Të ndryshëm dhe të barabartë, Tjetër Vizion, Qendra Psikosociale Vatra dhe Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit). Nuk kishte një shpërndarje të qëllimshme gjeografike të grupeve **të fokusuara**, të cilat u kryen në gjuhën shqipe, u transkriptuan nga moderatori dhe u **përkthyen në anglisht për qëllimin e analizës së të dhënave nga studiuesi kryesor**.

<sup>37</sup> Një intervistues i ndryshëm nga studiuesi që zhvilloi intervistat me të mbijetuarit.

### 3.2 Analiza e të dhënave

Intervistat dhe transkriptet e grupeve të fokusuara u futën në paketën e softuerit kompjuterik të analizës cilësore të të dhënave NVivo 12 (QSR International) dhe u krye analiza tematike për të identifikuar temat dhe modelet në përgjigjet e të mbijetuarve dhe të profesionistëve **në intervista dhe në pyetjet e diskutimeve** në grupe të fokusuara. Temat fillestare të shfaqura në analizë u përdorën për të zhvilluar kodet. Me vazhdimin e analizës, kategoritë e reja të dala nga të dhënat çuan në zhvillimin e kodeve shtesë. I gjithë materiali u analizua në këtë mënyrë dhe më pas u rilexua dhe u rianalizua për të përfunduar interpretimin dhe analizën e të dhënave.

Për të mbledhur manualisht informacionin kryesor për të mbijetuarit(at) (moshën, gjininë, marrëdhënien me trafikantin) dhe mbi trafikantët (moshën, gjininë, statusin e punësimit, nëse ata punonin si pjesë e një rrjeti kriminal) u përdor një skedar në Excel. U krijuan tabela të thjeshta për të raportuar, *ndër të tjera*, për shembull, numrin e të mbijetuarve që kishin marrë trajnime në fusha specifike, atyre që u raportuan se ishin në gjendje të zgjidhnin trajnimin e tyre profesional, atyre që u raportuan se ishin të kënaqur me trajnimin që kishin marrë dhe që ishin punësuar në kohën e intervistës në një fushë në të cilën ata ishin trajnuar.

### 3.3 Proceset etike

Gjatë studimit janë ndjekur të gjitha proceset etike të UNICEF-it. Përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave, studimi u miratua nga një bord i njohur i rishikimit të etikës, i quajtur *Health Media Lab Ltd.*<sup>38</sup>

Siç u theksua më sipër, përpara mbledhjes së të dhënave, u zhvillua një sesion trajnimi gjysmë ditor me intervistuesit, ku u dhanë udhëzime nga studiuesi kryesor dhe UNICEF-i në Shqipëri mbi proceset e identifikimit të të mbijetuarve që plotësonin kriteret e përfshirjes, rekrutimin e të mbijetuarve për intervistë, duke marrë miratimin e informuar, proceset e intervistave, duke trajtuar shqetësimet e mundshme gjatë intervistimit të pjesëmarrësve dhe duke siguruar konfidencialitetin e të mbijetuarve dhe transferimin e sigurt të skedarëve audio dhe transkripteve të intervistave te zyra e UNICEF-it në Shqipëri dhe për kërkuesin kryesor.

Konfidencialiteti i të mbijetuarve u ruajt gjatë gjithë studimit, nga identifikimi i pjesëmarrësve në studim, deri te transkriptimi i intervistave dhe transferimi i sigurt i skedarëve audio të intervistave në zyrën e UNICEF-it në Shqipëri dhe për kërkuesin kryesor.

Studimi i dha përparësi parimit “të mosdëmtimit”. Intervistat u paraprinë nga dhënia e miratimit nga të mbijetuarit(at), pas informimit të nevojshëm për secilin prej të intervistuarve mbi qëllimin e studimit dhe llojet e pyetjeve që do t'u bëheshin. Ky informacion u dha përmes një dokumenti me shkrim mbi pëlqimin e informuar (në gjuhën shqipe), dhe iu shpjegua me gojë secilit të mbijetuar, të cilët u informuan se nëse dëshironin, punonjësi social mund të merrte pjesë në intervistë. Më tej u shpjegua se psikologu ishte në gatishmëri për t'i mbështetur ata gjatë dhe pas intervistës dhe se ata mund të refuzonin të merrnin pjesë në intervistë, ta ndërprisnin intervistën në çdo kohë dhe të kërkonin në çdo moment para botimit të raportit që të dhënat e tyre të fshihen pa asnjë pasojë për ta.

Procesi i pëlqimit të informuar u krye gjithashtu edhe në lidhje me të gjitha intervistat individuale dhe diskutimet në grupe të fokusuara. Të gjithë të intervistuarit për këtë studim u pajisën me një dokument pëlqimi të informuar me shkrim në gjuhën shqipe që shpjegonte qëllimin e studimit, mënyrën se si do të përdorehin të dhënat e tyre, parimin e anonimitetit dhe se ata mund ta ndalonin intervistën në çdo kohë ose të kërkonin që të dhënat e tyre të fshiheshin.

<sup>38</sup>. Shih <https://www.healthmedialabirb.com/>

# 4

## Seksioni

## 4. Kufizimet e Studimit

### Pak të mbijetuar meshkuj ranë dakord të intervistoheshin për këtë studim

Vetëm pak të mbijetuar shprehën interes për të marrë pjesë në studim. Vetëm një mashkull i plotësoi kriteret e përfshirjes në studim dhe mori pjesë në intervistë. Ka disa arsye të mundshme për një numër kaq të vogël: shumica e të mbijetuarve të trafikimit të identifikuar në Shqipëri janë femra,<sup>39</sup> jo të gjitha strehëzat në Shqipëri mbështesin të mbijetuarit(at) e trafikimit meshkuj dhe, nga përvoja e studiuesit kryesor me studime të ngjashme që përfshijnë të mbijetuarit(at) e trafikimit, ka më pak meshkuj sesa femra të interesuar për të marrë pjesë në studime të tilla.

Ndikimi i një përfaqësimi kaq të vogël të të mbijetuarve meshkuj është se studimit i mungon një zë i ekuilibruar për sa i përket gjinisë. Intervista me mashkullin e vetëm ofroi të dhëna të pasura cilësore mbi përvojën e tij lidhur me aksesin për mbështetjen e riintegritimit ekonomik. Megjithatë, të dhënat e marra nga intervista nuk janë të mjaftueshme për të kuptuar në thellësi sfidat me të cilat përballen të mbijetuarit(at) meshkuj gjatë aksesit të trajnimit profesional, ndihmës për të gjetur punë, mbështetjes në biznes dhe shërbime të tjera. Për më tepër, asnjë risi nuk u identifikua përmes kësaj interviste të vetme. Gjithashtu, nuk kishte mundësi për krahasim të përvojave të të mbijetuarve meshkuj dhe femra në lidhje me ofrimin e mbështetjes dhe sfidat për të pasur akses në mbështetje riintegrimi ekonomik cilësor dhe të qëndrueshëm.

Ky kufizim u kompensua disi përmes mbledhjes së të dhënave cilësore lidhur me sfidat me të cilat përballëshin të mbijetuarit(at) meshkuj përmes intervistave të profesionistëve individuale dhe atyre pjesëmarrës në diskutime në grupe të fokusuara. Personave me njohuri mbi çështjen iu bënë pyetje konkrete lidhur me mangësitë dhe sfidat për të mbijetuarit(at) meshkuj lidhur me aksesin për mbështetje riintegrimi ekonomik cilësor dhe të qëndrueshëm.

### Kampioni nuk është përfaqësues për të gjithë të mbijetuarit(at) e trafikimit

Ky studim përdori një mostër të përshtatshme pa probabilitet dhe vetëm 14 intervista u kryen me të mbijetuarit(at). Për më tepër, studimi përfshiu vetëm intervistat e të mbijetuarve të cilët aktualisht po marrin mbështetje riintegruese nga strehëzat. Nuk u kryer asnjë intervistë me të mbijetuarit(at) që kishin dalë nga programi i mbështetjes. Në këtë mënyrë, gjetjet e studimit nuk janë të përgjithësuara për të gjithë të mbijetuarit(at) nga trafikimi. Megjithatë, gjetjet janë domethënëse dhe, për më tepër, novatore në lidhje me përmirësimin e të kuptuarit tonë rreth temës. Gjetjet do të jenë me interes dhe përdorim për politikëbërësit dhe profesionistët që punojnë në fushën e antitrafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht për ata që janë të përfshirë në parandalimin e trafikimit, mbrojtjen dhe riintegrimin e të mbijetuarve dhe në zhvillimin e politikave që luftojnë trafikimin në fushën e riintegritimit ekonomik të të mbijetuarve.

<sup>39</sup> Shih, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, 2021, Raporti i Trafikimit të Personave: [Trafficking in persons report: Albania](#). Shumica e viktimave të trafikimit të identifikuar në mbarë botën janë femra (shih, për shembull, raportet vjetore të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) mbi trafikimin e personave). Mendohet se kjo ndodh për shkak se policia është më e njohur me identifikimin e viktimave të trafikimit seksual (të cilat shpesh janë femra) sesa trafikimit për punë, dhe për shkak të nocionit të shtrembëruar se meshkujt nuk mund të jenë viktimë të trafikimit.

## Agjencitë shtetërore shpesh janë të pavetëdijshme se personat që kërkojnë mbështetje për riintegrim ekonomik nga shteti janë të mbijetuar trafikimi

Të mbijetuarit(at) mund të ndërveprojnë me agjenci të ndryshme shtetërore për të pasur akses në trajnim profesional, mbështetje për punësim dhe shërbime të tjera. Për shkak se të mbijetuarit(at) në përgjithësi nuk u japin informacion vullnetar këtyre agjencive në lidhje me statusin e tyre si të mbijetuar trafikimi, përfaqësuesit e agjencive nuk kanë asnjë mjet për të përcaktuar numrin e të mbijetuarve që po mbështesin. Për më tepër, përfaqësuesit e agjencive nuk mund të shtjellojnë sfidat me të cilat përballen lidhur me ofrimin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik për një grup të caktuar të të mbijetuarve të trafikimit, sepse ata nuk e dinë gjithmonë nëse janë në kontakt me një të mbijetuar të trafikimit, dhunës në familje apo ndonjë veprë tjetër penale. Për rrjedhojë, komentet e paraqitura në këtë raport nga agjencitë shtetërore janë deri diku të përgjithësuara për të gjitha grupet e cënueshme që mbështesin agjencitë.

## Studimi nuk mund të diskutojë nëse të mbijetuarit(at) në Shqipëri po marrin riintegrim të qëndrueshëm

Të drejtat e të mbijetuarve të trafikimit për mbështetje për mbrojtje dhe për riintegrim përshkruhen në disa instrumente ndërkombëtare dhe rajonale, duke përfshirë Protokollin e Kombeve të Bashkuara (OKB) për Parandalimin, Shtypjen dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve,<sup>40</sup> dhe Konventën e Këshillit të Evropës Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.<sup>41</sup> Të drejtat e të mbijetuarve të trafikimit për mbështetje për riintegrim, përfshirë mbështetjen për riintegrim ekonomik, përshkruhen më tej në legjislacionin kombëtar në shumë vende të botës. Për më tepër, ekzistojnë disa udhëzime jodetyruese të hartuara nga agjencitë e OKB-së dhe OJQ-të të cilët përshkruajnë më tej rëndësinë e ofrimit të mbështetjes gjithëpërfshirëse të riintegrimin për të mbijetuarit(at) e trafikimit.<sup>42</sup> Pavarësisht morisë së legjislacioneve dhe udhëzimeve që theksojnë të drejtat e të mbijetuarve për mbështetje për riintegrimin, legjislacioni dhe politikat e ndryshme ofrojnë vetëm një referencë të gjerë ndaj shërbimeve të riintegrimin ekonomik që profesionistët e shërbimeve duhet t'u ofrojnë të mbijetuarve. Ekziston një informacion shumë i kufizuar lidhur me sa shërbime saktësisht duhet t'u ofrojnë profesionistët e shërbimeve të mbijetuarve, kush duhet të ofrojë shërbimet dhe cila është kohëzgjatja e rekomanduar e mbështetjes. Në përmbledhje, **nuk ka asnjë udhëzim të hollësishëm lidhur me çfarë saktësisht përbën 'praktikën më të mirë' në mbështetjen për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit.** Për sa i përket përpjekjeve akademike për të dokumentuar praktikën më të mirë në fushën e riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit, një pjesë shumë e kufizuar e literaturës shqyrton pyetjen se çfarë përbën praktikë të mirë në mbështetjen për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve. Analiza e Surtees (2012) mbi riintegrimin e të mbijetuarve të trafikimit përqendrohet te 'fuqizimi' ekonomik i të mbijetuarve në Shqipëri, Bosnjë, Bullgari, Kosovë, Maqedoni, Rumania dhe Serbi.<sup>43</sup> Surtees thekson se një

<sup>40</sup> Kombet e Bashkuara, ("Protokolli për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional"), '[Protocol to Prevent, Suppress and Punish Trafficking in Persons Especially Women and Children, supplementing the United Nations Convention against Transnational Organized Crime](#)'. Nëntor 2000.

<sup>41</sup> Këshilli i Evropës, "Konventa Evropiane për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore." Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës - Nr. 197, Varshavë, maj 2005, f. 19.

<sup>42</sup> Shih, p.sh., Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), ("Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore"), '[Recommended principles and guidelines on human rights and human trafficking](#)'. 2002, f. 15 pp.; Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, (Udhëzime për të ndihmuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Rajonin e Afrikës Lindore), *Guidelines for assisting victims of human trafficking in the East Africa Region*. IOM, Gjenevë, 2011, f. 58.

<sup>43</sup> Surtees, Rebecca, ("Ri/integrimi i personave të trafikuar: mbështetja për fuqizimin ekonomik. Punimi me numër 4") '[Re/integration of trafficked persons: supporting economic empowerment. Issue paper No. 4](#)'. Fondacioni Mbreti Baudouin, Bruksel, Instituti NEXUS, Uashington, dhjetor 2012, f. 86.

tipar kryesor i (ri)integrit të suksesshëm është akses në një standard të arsyeshëm (dhe të qëndrueshëm) jetese, së bashku me mundësitë për rritje ekonomike. Kërkimi i saj konstaton se programet gjithëpërfshirëse të (ri)integritit shpesh përfshijnë komponentin e fuqizimit ekonomik, qoftë përmes trajnimit profesional dhe gjetjes së punës, ose përmes trajnimit të biznesit, planifikimit dhe mbështetjes për nisjen e një biznesi (*start-up-i*).<sup>44</sup> Megjithatë, dokumenti nuk identifikon se çfarë pamje ka “praktika më e mirë” në mbështetjen e riintegritit ekonomik.

Si rezultat i analizës së kufizuar, ka udhëzime të kufizuara të cilat mund të mbështetemi për të bërë ndonjë koment konkret në lidhje me nëse të mbijetuarve në Shqipëri u ofrohen shërbimet e duhura, për kohëzgjatjen e duhur. **Nuk është e mundur të sugjerohet që të mbijetuarit(at) në kampionin aktual të studimit po riintegroheshin me sukses, sepse nuk ka asnjë pikë referimi për të matur suksesin e riintegritit ekonomik të të mbijetuarve.** Për më tepër, shumica e të mbijetuarve në kampionin e studimit ishin, gjatë kohës së intervistës, ende të angazhuar në trajnime profesionale. Për rrjedhojë, është e pamundur që raporti të bëjë komente nëse të mbijetuarit(at) janë riintegruar me sukses pasi ata janë ende në procesin e riintegritit ekonomik. Për këto arsye, raporti nuk i referohet riintegritit të suksesshëm ekonomik dhe nuk përpiqet të diskutojë nëse të mbijetuarit(at) që morën pjesë në këtë studim, ose të mbijetuarit(at) më gjerësisht në Shqipëri, po arrijnë një riintegrim të qëndrueshëm. Kur përdoret termi ‘mbështetje e qëndrueshme’, ai përdoret vetëm për t’iu referuar natyrës afatgjatë dhe të qëndrueshme të ofrimit të shërbimit (mbështetjes) dhe nuk është projektuar për të sugjeruar riintegrim të suksesshëm ekonomik.

## Paragjykimi

Ekipi kërkimor u përpoq të zbuste paragjykimet në fazën e planifikimit të studimit përmes organizimit të një seance trajnimit gjysmëditore me intervistuesit për të kuptuar qëllimin e pyetjeve të intervistës dhe rëndësinë e lënies mënjanë të çdo paragjykimi negativ ndaj profesionistëve të shërbimeve. Paragjykimi u menaxhua më tej përmes **studiueses kryesore**, e cila ka pak përvojë paraprake me angazhimin e profesionistëve të shërbimeve në Shqipëri (dhe, për rrjedhojë nuk ka paragjykim ndaj ose kundër tyre), përmes kryerjes së analizës së të dhënave dhe shkrimit të këtij raporti.

<sup>44</sup>. Po aty.

# 5

Seksioni

## 5. Gjetjet e studimit

Në këtë seksion të raportit paraqiten gjetjet e studimit. Së pari, ai eksploron formimin profesional për të mbijetuarit(at) e trafikimit, përpara se të diskutojë mbështetjen për të mbijetuarit(at) nëpërmjet praktikave profesionale dhe punësimit, si dhe mbështetjen për të nisur një biznes të vogël. Seksioni më pas eksploron shërbimet e tjera pararendëse (p.sh., arsimin, kujdesin shëndetësor, strehimin dhe ndihmën ekonomike), të cilat mund të aksesohen nga të mbijetuarit(at) dhe që mbështesin riintegrimin e tyre ekonomik. Gjetjet paraqiten në këtë mënyrë, sepse kjo strukturë ilustron më së miri natyrën kronologjike të disa aspekteve të ofrimit të shërbimeve të riintegrimin ekonomik: të mbijetuarit(at) fillimisht marrin trajnim profesional përpara se të nisin praktikën profesionale, punën ose të hapin një biznes. Megjithatë, ky seksion i gjetjeve do të shpjegojë se si mbështetja për riintegrimin ekonomik nuk është një proces linear dhe do të theksojë se si ofrimi i shërbimeve të integruara është thelbësor për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve.

### 5.1 Mbështetje për trajnim profesional për të mbijetuarit(at) e trafikimit

Nga 14 të mbijetuarit(at) e intervistuar për këtë studim, në kohën e intervistës shumica kishin marrë ose ishin duke marrë trajnim profesional në fushën e shërbimeve të bukurisë (parukeri, masazh, lyerje të thonjve) (n=8) dhe/ose gatim (n=7), të pasuara nga rrobaqepësia (n=5), teknologjia e informacionit (IT) (n=3), hoteleria (n=2), prodhimi i bizhuterive (n=1) dhe riparimi i automjeteve (n=1).<sup>45</sup> Të mbijetuarit(at) gjithashtu raportuan se merrnin pjesë në orë mësimi që do të kontribuonin për punësimin e tyre, të tilla si për gjuhë të huaja (anglisht, gjermanisht; n=2) dhe menaxhim biznesi (n=3).

Të 14 të mbijetuarit(at) e intervistuar raportuan se streha ose qendra që i mbështeste ata kishte organizuar trajnimet profesionale. Për sa i përket kohëzgjatjes, 11 të mbijetuar (79%) raportuan se trajnimi kishte zgjatur nga një deri në nëntë muaj, ndërsa shumica raportoi se kurset kishin zgjatur përafërsisht tre muaj. Tre të mbijetuar të intervistuar (21%) raportuan se kishin marrë trajnim profesional për më shumë se një vit.

**Shtatë të mbijetuar të intervistuar (50%) raportuan se ishin trajnuar në një nga dhjetë qendrat shtetërore të formimit profesional në një nga qendrat urbane të vendit. Katër të mbijetuar (29%) raportuan se trajnimi ishte ofruar nga një qendër private trajnimi ose një organizatë sektori, p.sh., një sallon parukerie ose një hotel. I vetmi i mbijetuar mashkull që mori pjesë në studim raportoi se ai kishte marrë trajnim në gatim në një qendër private trajnimi. Qendrat private aplikojnë tarifa trajnimi, të cilat paguheshin në mënyrë të barabartë nga strehëza ose qendra dhe nga i mbijetuari.**

Pesë të mbijetuar<sup>46</sup> (36%) raportuan se kishin marrë trajnim vetëm nga strehëza e menaxhuar nga OJQ-të. Ndërsa ky trajnim ofrohet nga stafi i strehëzës pa ofrimin e një certificate trajnimi në fund, pavarësisht kësaj, të mbijetuarit(at) raportuan se kishin fituar aftësi, *ndër të tjera*, nga trajnimi për menaxhim biznesi, gjuhë të huaja dhe TI.

**Të 14 të mbijetuarit(at) e intervistuar deklaruan se ishin në gjendje të zgjidhnin formimin profesional që dëshironin të merrnin nga opsionet e paraqitura. Dhjetë prej tyre (71%) raportuan se besojnë se trajnimi i kishte përgatitur ata për punësim, megjithëse dy (14%) mendonin se trajnimi ishte i pamjaftueshëm dhe nuk i kishte rritur aftësitë e tyre për punësim. Dy të mbijetuar të tjerë (14%) thanë se ishte e parakohshme që ata t'u përgjigjeshin pyetjeve se sa të gatshëm ishin për t'u punësuar për shkak të formimit profesional, sepse, në kohën e intervistës, ata ishin ende në shkollë dhe nuk**

<sup>45</sup> Këto shifra po të mbledhen nuk shkojnë në 14 sepse disa të mbijetuar raportuan se kishin marrë trajnime në më shumë se një fushë.

<sup>46</sup> Po aty.



mendonin ende për punësim.

Intervistat e kryera me të mbijetuarit(at) dhe profesionistët nxorën në pah se **është jashtëzakonisht e rëndësishme për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve që ata të kenë informacion mbi opsionet e formimit profesional dhe të jenë në gjendje të marrin vendime në lidhje me trajnimin që dëshirojnë të ndërmarrin. Është gjithashtu e rëndësishme që opsionet e paraqitura për të mbijetuarit(at) të jenë ato që ka të ngjarë të çojnë në punësim të mirë dhe mundësi biznesi.** Sipas personave me njohuri mbi çështjen, është e rëndësishme që këto opsione të përputhen sa më shumë që të jetë e mundur me nivelin e arsimimit të të mbijetuarve dhe mundësitë e punësimit dhe biznesit. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që të mbijetuarit(at) të jenë në gjendje të gjejnë punë të denjë pas përfundimit të trajnimit profesional.

“Gjëja e parë që merret parasysh është nëse ata janë të apasionuar pas ndonjë gjëje në veçanti; disa të mbijetuar kanë ide të qarta lidhur me atë që duan të mësojnë. Elemente të tjera të vlerësuara janë aftësitë e tyre, arsimimi, kapacitetet fizike, gjendja e shëndetit mendor dhe madje edhe angazhimet familjare. Gjithashtu, ne mundohemi t’i përputhim aftësitë e tyre me tregun e punës, sepse pas trajnimit duam që ata të kenë mundësi pune.”

**Profesionist**

Një fill i përbashkët që i përshkronte intervistat me të mbijetuarit(at) për këtë studim ishte se **ata që janë në gjendje të zgjedhin formimin e tyre profesional dhe janë të apasionuar pas trajnimit që marrin, ka të ngjarë ta përfundojnë trajnimin dhe të punojnë në atë fushë.** Siç sugjeron përgjigja e mëposhtme, **formimi profesional në një fushë për të cilën i mbijetuari është i apasionuar mund të ketë gjithashtu përfitime të konsiderueshme për sa i përket rimëkëmbjes së tij/saj të përgjithshme.**

“Unë zgjodha kursin e gatimit sepse më pëlqen gatimi, të cilin e kam pasion. Më ka pëlqyer gatimi që kur kam qenë i vogël, sepse më pëlqen të përziej dhe të eksperimentoj me përbërës të ndryshëm.”

### **I mbijetuari mashkull**

Profesionistët e intervistuar theksuan më tej **se rruga nga formimi profesional drejt punësimit ose nisjes së një biznesi nuk është domosdoshmërisht lineare dhe riintegrimi ekonomik nuk përfundon në fazën e punësimit.** Profesionistët e intervistuar raportuan se **është e rëndësishme që profesionistët e shërbimeve të ndjekin ciklin këshillues,** ku për rreth nëntë muaj të mbijetuarit(at) marrin trajnime profesionale dhe aftësi për jetën, ndërgjegjësohen për tregun shqiptar të punës dhe kanë mundësi të kryejnë praktika profesionale. Gjatë gjithë ciklit, i mbijetuari mbështetet, nëpërmjet diskutimeve me profesionistët e shërbimeve, lidhur me nivelin e interesit të tij/saj për trajnimin profesional. Kur ata dëshirojnë të ndjekin një mundësi të caktuar, si për shembull një praktike profesionale, ata mbështeten nga profesionistët për ta bërë këtë. Dhe kur shprehin pak interes për formimin profesional ose një punë të caktuar, ata mbështeten për të ndjekur mundësi të tjera. Pra, **cikli këshillues ofron një kornizë për të mbijetuarin që të eksplorojë një gamë mundësish trajnimi, ndërkohë që gjatë gjithë kohës ata udhëhiqen nga këshillat dhe mbështetja nga profesionistët e shërbimeve.**

“Në ciklin e këshillimit, i mbijetuari fiton aftësi për jetën dhe aftësi profesionale, plus udhëzime lidhur me atë që një personi mund t’i duhet në jetën e tij/saj, për nëntë muaj. Nëpërmjet këtij këshillimi, përfituesi përfiton një praktikë profesionale afatshkurtër, një udhëzues për qytetin që informon për llojet dhe numrin e bizneseve për lloj, ato më mbizotërueset, dhe ato që janë zhvilluar me diçka të veçantë. Qëllimi është ta çojmë përfituesin drejt objektivit përfundimtar të programit – domethënë punësimit – por duke e kaluar të gjithë procesin në thellësi.”

#### Pjesëmarrës në intervistë

Intervistat me të mbijetuarit(at) identifikuan se **formimi profesional duhet të përfshijë aftësitë e jetës dhe komponentët e menaxhimit të biznesit**. Të mbijetuarit(at) që nuk kanë qenë të punësuar më parë, ose nuk janë punësuar në pozicione profesionale, mund të kenë nevojë për mbështetje për të kuptuar, p.sh., standardet e lidhura me mënyrën e të veshurit në punë, përpikmërinë dhe marrëdhëniet me klientët. Ata që dëshirojnë të hapin biznesin e tyre mund të kërkojnë mbështetje për të kuptuar planifikimin e biznesit, rëndësinë e vlerësimeve të tregut, menaxhimin e financave, teknologjinë dhe informacionin. Pa këto aftësi, vetëm formimi profesional mund të jetë i pamjaftueshëm për të siguruar rrugëtimin për të mbijetuarit(at) drejt punësimit të qëndrueshëm të denjë.

“Stafi i shkollës së trajnimit më rriti vetëvlerësimin dhe vetëbesimin.”

#### E mbijetuar femër

Një gjetje tjetër kryesore nga intervistat me të mbijetuarit(at) është **se certifikata e trajnimit është shumë e rëndësishme për të mbijetuarit(at)**. Pas përfundimit me sukses të trajnimit në një shkollë profesionale apo organizatë private, çdo pjesëmarrës merr një certifikatë, e cila u theksua nga të intervistuarit si shumë e rëndësishme për fazën pasuese të riintegritit ekonomik, pra për hyrjen në punësim. Pa certifikatën nuk ka asnjë provë që i mbijetuari ka marrë trajnim dhe aftësi në fushën në të cilën ai/ajo kërkon punësim. **Për rrjedhojë, certifikata e trajnimit është shumë e rëndësishme për hapjen e rrugës drejt punësimit.**

Intervistat e kryera për këtë studim nxorën në pah disa mangësi dhe sfida kryesore për sa i përket aftësisë së të mbijetuarve për të pasur një trajnim cilësor profesional. Një sfidë konkrete për personat me fëmijë ishte disponueshmëria e kujdesit falas për fëmijët. **Të mbijetuarit(at) me fëmijë të vegjël raportuan se e kishin shumë të vështirë të përfshiheshin në trajnime profesionale kur nuk kishin fare ose kishin akses të kufizuar të shërbimeve falas të kujdesit për fëmijët.**

“Unë mund të merrja pjesë në orët e parukerisë; ato m’u ofruan mua, por nuk kishte kush më ndihmonte me vajzën time.”

#### E mbijetuar femër

Intervistat individuale me profesionistët dhe diskutime në grupe të fokusuara theksuan më tej se **formimi profesional është i vështirë për t’u aksesuar për të mbijetuarit(at) që jetojnë në pjesët rurale të vendit**. Shkollat shtetërore të formimit profesional janë të pranishme vetëm në qendrat

urbane. Të mbijetuarit(at) që jetojnë larg shkollës profesionale kanë një rrugë të gjatë për të bërë, ose thjesht nuk regjistrohen fare në formimin profesional.

Ndërsa vetëm dy të mbijetuar (14%) kritikuan kohëzgjatjen dhe cilësinë e trajnimit në qendrat e trajnimit profesional, **profesionistët e intervistuar theksuan se qendrat shpesh kanë mungesë të burimeve dhe se trajnimet që ofrohen (edhe për personat e tjerë të regjistruar në programe) janë shpesh të pamjaftueshme për të përgatitur të trajnuarit për punësim.** Megjithatë trajnimet zakonisht zgjasin disa muaj, në fund, kursantët kanë mësuar vetëm bazat e një profesioni. Një e mbijetuar e intervistuar përshkroi se si ajo u trajnuar për disa muaj për parukeri, por se detyrat e thjeshta, të tilla si drejtimi i flokëve përsëriteshin çdo ditë, ndërsa parimeve të rëndësishme të tilla si siguria nuk i kushtohej vëmendje.

## 5.2 Praktikrat profesionale dhe mbështetja për punësim

Pas përfundimit të trajnimit profesional, të mbijetuarit(at) ndihmohen nga profesionistët të shërbimeve për t'u regjistruar në praktika profesionale ose për të gjetur punë të denja.<sup>47</sup>

Studimi identifikoi se **praktikat profesionale janë një rrugë e vlefshme drejt punësimit të denjë.** Profesionistët e intervistuar dhe ato pjesëmarrës në diskutime në grupe të fokusuar, **sugjeruan se është e rëndësishme që praktikrat profesionale të paguhen. Një praktikë e mirë aktuale është që një strehëz e menaxhuar nga OJQ-të përcakton pagën normale për punësim në një sektor të caktuar dhe më pas mundëson me kompaninë që punëson të mbijetuarin si praktikant që të t'i paguhet e njëjta shumë si një punonjës i rregullt.** Strehëza financon biznesin për të marrë të mbijetuarin si praktikant për disa muaj dhe biznesi paguan praktikantin. **Për të mbijetuarit(at) që nuk kanë punuar më parë, ky proces i ndihmon ata të mësohen të marrin pagesa të rregullta nga punëdhënësi i tyre dhe rrit aftësitë e tyre të menaxhimit të buxhetit dhe vetëbesimin e përgjithshëm për të hyrë në tregun e punës.**

Profesionistët e intervistuar për këtë studim theksuan gjithashtu se **praktikat profesionale janë një mundësi e rëndësishme për të mësuar që duhet t'i paraprijë punësimit për të mbijetuarit(at) që nuk kanë punuar më parë. Praktikrat profesionale u ofrojnë atyre një mundësi që të mësojnë më shumë rreth një profesioni të caktuar përmes trajnimit në punë dhe të përcaktojnë nëse janë të interesuar për punën.**

“Së pari, ofrova trajnime dhe praktika sepse vajzat nuk dinin si të punonin, pasi nuk kanë punuar më parë në jetë. Kjo është arsyeja pse fillimisht më duhej të ofroja trajnimin dhe më pas t'i punësoja. I punësova të tre të mbijetuarit(at)”

### Pjesëmarrës në studim

Studimi identifikoi se **është e rëndësishme, përpara se të mbijetuarit(at) të fillojnë praktikën, që profesionistët e shërbimeve të kontrollojnë çdo kompani që do të punësojë praktikantët.** Një verifikim i tillë mund të ndihmojë për të siguruar që të mbijetuarit(at) nuk do të riviktimizohen nga punëdhënësit ose kolegët e tyre të rinj.

<sup>47</sup> Siç theksohet nga ILO, puna 'e denjë' do të thotë: pagë e drejtë; kushte të sigurta pune; mundësi të barabarta dhe trajtim; mbrojtje sociale për punëtorët dhe familjet e tyre; mundësi për zhvillim personal; dhe aftësi për të shprehur shqetësimet në lidhje me punën dhe për t'u organizuar përmes sindikatave.

Studimi identifikoi se profesionistët e shërbimeve kanë qenë të suksesshëm lidhur me mbështetjen e të mbijetuarve gjatë trajnimit profesional në punësim me pagesë. Ai gjithashtu identifikoi se **shumë të mbijetuar ia dalin me sukses të gjejnë punë në fushën në të cilën janë trajnuar: shtatë të mbijetuar të intervistuar (50%), në kohën e intervistës, ishin të punësuar në të njëjtën fushë në të cilën ishin trajnuar: si robaqepës, parukiere, kuzhinier, mekanik makinash ose profesion tjetër.**

Intervistat me të mbijetuarit(at) dhe personat me informacion mbi çështjen identifikuan gjithashtu disa **sfida në lidhje me aftësinë e të mbijetuarve për t'u angazhuar në punësim të denjë, duke përfshirë, por sigurisht jo kufizuar në, natyrën e vështirë të (ri)hyrjes në punësim dhe mungesën e arsimit, kujdesin falas për fëmijët dhe mundësitë për punë të denjë në Shqipëri. Këto sfida janë të rëndësishme në nivel individual, komuniteti dhe shoqëror.**

Në nivel individual, studimi konstatoi se **(ri)hyrja në punë mund të jetë një proces i vështirë dhe kërkues për shumë njerëz.** Jo të gjithë të mbijetuarit(at) që u intervistuan kishin punuar përpara se të trafikoheshin. Gjashtë prej tyre (43%) raportuan se nuk kishin punuar kurrë më parë, dhe në të gjitha ato raste sepse kishin qenë shumë të rinj. Për këtë arsye, hyrja në punë për të mbijetuarit(at) që nuk kanë punuar më parë mund të jetë një proces shumë frikësues, duke përfshirë jo vetëm një mjedis të ri, por edhe vënien në përdorim të aftësive të fituara rishtazi, orët e gjata të punës dhe kontaktin e mundshëm ballë për ballë me publikun. **Pa përgatitjen e përshtatshme, përmes trajnimit profesional dhe trajnimit të aftësive, dhe mbështetjes së vazhdueshme nga profesionistët e shërbimeve dhe punëdhënësit, hyrja në tregun e punës mund të jetë e vështirë.**

Një sfidë tjetër për të pasur një punësim të denjë në nivel individual është niveli i ulët arsimor. Të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e intervistuar për këtë studim raportuan se, **për ata që nuk kishin punuar më parë, ose nuk kishin përfunduar shkollën e mesme, mundësitë e punësimit ishin të kufizuara.**

**Hyrja në punë për të mbijetuarit(at) shpesh përkon me daljen e tyre nga strehëza dhe me jetesën në një vend të ri.** Faktorët e nivelit individual dhe të komunitetit hyjnë në lojë në situata të tilla. Për disa të mbijetuar, hyrja në punë kërkon lëvizjen në një qytet tjetër, gjetjen e një apartamenti dhe jetesën e pavarur. Këta faktorë, të kombinuar, mund të çojnë ose në ndërtimin e vetëbesimit dhe të jenë fuqizuese, ose mund të jenë stresues dhe shqetësues. **Për këtë arsye, disa të mbijetuar kërkojnë mbështetje më intensive kur gjejnë një punë të re.**

Ndërkohë, në nivel komuniteti, mundësitë e punësimit të denjë për të mbijetuarit(at) me fëmijë janë gjithashtu të pakta. Intervistat me të mbijetuarit(at) dhe profesionistët pjesëmarrës në diskutime në grupe të fokusuar komentuan se mungesa e kujdesit falas për fëmijët pengon aftësinë e të mbijetuarve për të mbajtur një punë të denjë. Të mbijetuarit(at) me fëmijë shpesh detyrohen të punojnë në një ose më shumë punë me kohë të pjesshme, ose përpiqen të menaxhojnë një biznes të vogël nga shtëpia.

**Në nivel shoqërie, një sfidë kryesore për të mbijetuarit(at) për sigurimin e aksesit në një punë të denjë është se ka pak mundësi pune të denjë për të mbijetuarit(at) në Shqipëri.** Niveli i papunësisë në Shqipëri po rritet dhe është veçanërisht i lartë tek të rinjtë.<sup>48</sup> Para pandemisë COVID-19, niveli i papunësisë ishte në rënie të vazhdueshme. Megjithatë, mendohet se pandemia përmbys çdo rritje. Literatura e fundit thekson se, në një klimë papunësie në rritje, shanset e të mbijetuarve të trafikimit për të gjetur punë fitimprurëse janë të vogla. Shanset që një person i tillë të gjejë punë nuk mund të priten të jenë më të larta se sa për të papunët e tjerë, të cilat gjithsesi janë shumë të ulëta.<sup>49</sup>

<sup>48</sup>. INSTAT, Anketa tremujore e forcave të punës – 2022” (në shqip). Qershor 2022, f. 8. ‘[Labour Market Survey – 1st Quarter 2022](#)’.

<sup>49</sup>. Tahiraj, Enkelejd, “Kuptimi i trafikimit të vajzave dhe grave nga Shqipëria.” Programi Shpresa, korrik 2017, korrik 2017.

“COVID-19-a ka shkaktuar humbjen e vendit të punës për shumë persona, për shkak se bizneset nuk e përballonin t’i mbanin të gjithë punëtorët.”

### Profesionist

**Të mbijetuarit(at) kanë gjithashtu shumë sfida për ta mbajtur punën, dhe shumë nga këto sfida janë në nivel individual, komuniteti dhe shoqëror.** Individualisht ata mund të mos jenë të interesuar për punën e tyre të re. Të intervistuarit që morën pjesë në intervista individuale ose në diskutime në grupe të fokusuar raportuan se, pavarësisht ciklit këshillues të lartpërmendur, **disa të mbijetuar kanë ide jorealiste për punën në të cilën do të angazhohen pas formimit profesional.** Me arsim të kufizuar dhe me pak ose edhe aspak përvojë pune, disa të rinj të mbijetuar mund të shprehin interes për t’u angazhuar në profesione të caktuara që nuk përputhen me nivelin e tyre arsimor dhe historikun e punësimit. **Kur ata mbështeten për të hyrë në një punë që është më e përshtatshme për arsimin dhe grupin e tyre të aftësive, por jo profesionin e tyre të preferuar, ata mund të zhgënjehen me punën (natyra e përsëritur e detyrave dhe orët e gjata të punës) dhe mund ta lënë punën për shkak të mërzi së ose lodhjes pas disa ditësh ose javësh.** Ky konstatim përputhet me literaturën, e cila sugjeron se, veçanërisht në fillim të procesit të riintegrit, disa të mbijetuar kanë ide të paqarta ose pritshmëri jorealiste se cili mund të jetë profesioni i tyre i ardhshëm.<sup>50</sup> **Ky konstatim thekson rëndësinë e ciklit këshillues: të mbijetuarit(at) kanë nevojë për udhëzime për të kuptuar tregun e punës dhe kërkesat për punët e tyre të preferuara, në mënyrë që të menaxhojnë pritshmëritë dhe qëllimet në lidhje me punën dhe të ardhurat në të ardhmen.**

“Unë hoqa dorë sepse ishte e vështirë. Të duhej të nxitoheshe për çdo gjë. Të duhej të filloje të punoje sapo vinte porosia dhe ndërsa ti merreshe me atë porosi, të vinte porosia tjetër, e kështu me radhë.”

### E mbijetuar femër

Gjithashtu në nivel individual, **të mbijetuarit(at) që janë ende duke studiuar në universitet ose shkollë ose po marrin pjesë në trajnime profesionale gjithashtu përballen me sfida të mëdha për mbajtjen e punës, për shkak të agjendave të tyre të ngjeshura.** Të mbijetuarit(at) e intervistuar theksuan se studimi, trajnimi dhe puna shpesh zhvillohen në vende të ndryshme dhe është shumë e vështirë për ta që të mbajnë përgjegjësitë e studimit dhe të punësimit, gjë që mund t’i detyrojë ata të heqin dorë nga një mundësi.

“Ata [punëdhënësit] më thanë se më donin që unë të isha atje [në punë]. Unë u thashë se duhet të shkoja në shkollë në orën 3 pasdite, por ata insistuan që unë duhet të isha atje, kështu që unë vendosa ta lija punën.”

### E mbijetuar femër

Një faktor tjetër në nivel individual është se **disa të mbijetuar vuajnë nga trauma të vazhdueshme, gjë që zvogëlon aftësinë e tyre për të mbajtur vendin e punës.** Profesionistët e shërbimeve janë

<sup>50</sup>. Të Ndryshëm dhe të Barabartë, 2015, Të biesh në boshllëk! Trafikimi i meshkujve dhe djemve në Shqipëri, janar 2015. 72 f.

të kujdesshëm për të mos i vendosur të mbijetuarit(at) e trafikuar për shfrytëzim seksual në vende pune të tilla si në hotele, pasi kjo mund të shkaktojë rikthimin e kujtimeve të shfrytëzimit. Megjithatë, me gjithë përpjekjet e tyre më të mira për t'i përgatitur të mbijetuarit(at) për punësim, në disa raste trauma është e konsiderueshme dhe të mbijetuarit(at) ende konstatojnë se janë të frikësuar ose të stresuar në situatat e punës.

**Në nivel komuniteti, një sfidë e madhe për të mbijetuarit(at) me fëmijë për të pasur një punë të qëndrueshme është mospërputhja e orëve të punës me disponueshmërinë e kujdesit falas ose të përballeshëm për fëmijët.** Në rast se punëdhënësit nuk do të lejojnë një të mbijetuar me fëmijë të punojë gjatë orëve të tyre të preferuara, i mbijetuari mund të detyrohet ta lërë punën e re.

“Kujdesi ndaj fëmijëve është pak i vështirë për ta. Ai përbën një ndër vështirësitë kryesore për të mbajtur vendin e punës.”

Profesionist

**Një sfidë tjetër kyçe në nivel komuniteti për të mbijetuarit(at) për sa i përket ruajtjes së vendit të punës është ajo e stigmës.** Si të mbijetuarit(at), ashtu edhe profesionistët e intervistuar raportuan se një i mbijetuar mund t'i përmendë një kolegu se ata janë trafikuar, duke bërë që i mbijetuari të stigmatizohet nga kolegët e tij/saj dhe të ndihet aq i diskriminuar saqë të detyrohet të lërë punën e re.

“Ndonjëherë ata flasin me kolegët rreth statusit të tyre dhe bashkë me këtë vjen stigmatizimi dhe diskriminimi. **Më pas ata ndihen të mbingarkuar dhe e lënë punën.**”

Profesionist

**Në nivel shoqërie, një sfidë kryesore për ruajtjen e vendit të punës është se, në disa raste, paga është shumë e vogël që të mbijetuarit(at) të paguajnë qiranë dhe gjërat e tjera bazike.** Kjo duket se është problematike në qytete si Tirana, ku qiraja është më e larta në Shqipëri. Rrjedhimisht, të mbijetuarit(at) mund ta lënë punën e tyre të re për të ndjekur mundësi të tjera trajnimi dhe punësimi.

Gjithashtu në këtë nivel, intervistat e kryera për këtë studim identifikuan **se jo të gjithë të mbijetuarit(at) gjejnë punë pasi regjistrohen në AKPA.** Shumë presin për një kohë të gjatë pas dorëzimit të kërkesës për mbështetje për punësim përmes agjencisë dhe mund të presin edhe shumë muaj të tjerë përpara se t'u ofrohet punë. Ky konstatim përputhet gjithashtu me literaturën ku studiuesit argumentojnë se ndërsa të mbijetuarit(at) e papunë kanë të drejtë të regjistrohen si punëkërkuar në AKPA, shërbimi është një proces që kërkon kohë dhe është demotivues për të mbijetuarit(at) e trafikimit, të cilët shpesh presin shumë muaj për të gjetur një punë, duke çuar kështu në mungesë të qëndrueshmërisë financiare dhe tjetërsimit të çdo përfitimi të shëndetit mendor.<sup>51</sup> Ky studim identifikoi se si rezultat i kohëve të gjata të pritjes në AKPA, shumë të mbijetuar zgjedhin të gjejnë punë përmes informacioneve informale ose kanaleve të tjera.

<sup>51</sup> Ramaj, Klea, 'Pasoja e trafikimit të qenieve njerëzore: Eksplorimi i sfidave të kthimit, rehabilitimit dhe riintegrit të viktimave shqiptare. *Gazeta e Trafikimit të Njerëzve*, 2021, f. 22.

“Shkova për të kërkuar ndihmë për të gjetur një vend pune, por proceset e tyre [AKPA] janë të gjata, kështu që unë e gjeta këtë punën tjetër shumë më shpejt.”

### E mbijetuar femër

Gjithashtu, në nivel shoqërie, disa të mbijetuar **përfytyrojnë stigmë kur angazhohen me stafin e zyrës së AKPA-së**. Disa të mbijetuar raportuan se ndjeheshin të diskriminuar nga stafi i AKPA-së për shkak të mungesës së arsimimit dhe aftësive për punësim. Një e intervistuar raportoi se ajo ishte ndjerë e nënçmuar nga stafi i AKPA-së dhe se ishte larguar pa asnjë ndihmë për punësim.

Ka rreziqe dhe pasoja negative të paaftësisë së të mbijetuarve për të hyrë në tregun e punës dhe për të mbajtur një punë të denjë në Shqipëri. Disa mund t'i diskutojnë shqetësimet dhe pengesat e lidhura me punësimin me profesionistët e shërbimeve dhe më pas të regjistrohen në trajnime shtesë për të ndjekur punësimin në një fushë alternative. Megjithatë, disa të mbijetuar mund të detyrohen të punësohen në dy punë me kohë të pjesshme që nuk kanë siguri dhe kushte të mira pune, ndërsa të tjerë mund të mendojnë mundësinë e (ri)emigrimit, i cili shoqërohet me rreziqet për ritrafikim. Ky konstatim nxjerr në pah rëndësinë e ciklit këshillues dhe të të mbijetuarve që referohen në shërbime gjithëpërfshirëse dhe të integruara të riintegrimit ekonomik.

## 5.3 Hapja e një biznesi

Disa të mbijetuar janë më të interesuar të marrin mbështetje për të hapur një biznes të tyre, sesa mbështetje për të gjetur një punë. Disa të mbijetuar të intervistuar, në kohën e intervistës, kishin biznesin e tyre, p.sh., merreshin me riparime automjesh, rrobaqepësi, manikyr-pedikyr, ose shitje veshjesh. Disa të tjerë po mendonin të hapnin biznesin e tyre pas përfundimit të trajnimit profesional.

Të mbijetuarit(at) që dëshirojnë të hapin biznesin e tyre mbështeten nga profesionistët e shërbimeve gjatë ciklit këshillues. Këta profesionistët diskutojnë me të mbijetuarin idenë e propozuar të biznesit dhe vlerësojnë qëndrueshmërinë e biznesit përmes marrjes përsipër të një vlerësimi bazë të tregut. Nëse vlerësimi tregon se ka shumë pak të ngjarë që biznesi të jetë i suksesshëm, profesionistët e shërbimeve e këshillojnë të mbijetuarin të marrë parasysh ide të tjera biznesi, ose të kërkojë një punë të denjë. Kur vlerësimi i tregut përcakton se biznesi mund të jetë i suksesshëm, të mbijetuarit(at) pajisen me aftësitë kyçe që i nevojiten për të hapur biznesin. Këtu përfshihet formimi profesional dhe trajnimi mbi menaxhimin e biznesit, duke përfshirë IT-në dhe menaxhimin e financave. Profesionistët e shërbimeve gjithashtu mbështesin të mbijetuarit(at) për të hapur një biznes të ri duke ofruar disa pajisje dhe mjete të tjera, të tilla si makina qepëse, tharëse flokësh, drejtues flokësh ose pasqyra.

“Qendra na ofroi kursin, pajisjet e punës, raftet, pasqyrat dhe tavolinat. Nuk më nevojitej asgjë tjetër.”

### E mbijetuar femër

Intervistat e kryera për këtë studim nxorën në pah se **hapja e një biznesi mund të jetë një përvojë shumë fuqizuese për të mbijetuarit(at)**. Nëpërmjet trajnimeve profesionale dhe të menaxhimit të biznesit, të mbijetuarit(at) fitojnë aftësi për menaxhimin e biznesit dhe financave, të cilat më

pas zbatohen përmes krijimit dhe menaxhimit të biznesit. **Gjatë gjithë procesit të planifikimit dhe fillimit dhe menaxhimit të një biznesi, të mbijetuarit(at) mund të përjetojnë nivele të larta vetëbesimi.**

“Bëra kërkime tregu dhe më erdhi kjo ide biznesi. Kam kryer kërkime tregu, kam organizuar intervistat, kam shkuar në vendet e punës, kam lexuar për ofertat dhe kërkesat; bëra gjithçka që munda.”

#### E mbijetuar femër

Intervistat e kryera për studimin theksuan gjithashtu **se është e rëndësishme që të mbijetuarit(at) të mbështeten për të ndjekur aktivitetin e tyre të preferuar të biznesit, edhe kur ideja mund të sfidojë stereotipet gjinore, p.sh., bizneset e përshtatshme për gratë.** Një pjesëmarrëse në intervistë përshkroi se si ajo shprehu një interes për profesionistët e shërbimeve për të hapur një biznes për riparimin e automomjeteve. Profesionistët ishin jashtëzakonisht mbështetës për planin e saj të biznesit dhe e mbështetën atë për të gjetur trajnimin e duhur dhe për të hartuar planin.

“Edhe njerëzit në qendër [strehëz] u habitën nga një vendim i tillë. Qendra ra dakord me mua dhe kështu më dha një shans. Ata u habitën [më vonë] se si gjërat kanë ndryshuar. Unë u jam shumë mirënjohës për ndihmën dhe inkurajimin e tyre.”

#### E mbijetuar femër

**Megjithatë, ka edhe shumë sfida me të cilat përballen të mbijetuarit(at) që hapin dhe mbajnë biznesin e tyre, duke përfshirë, por sigurisht pa u kufizuar në, mungesën e njohurive të biznesit të të mbijetuarve, mungesën e kapitalit fillestar, konkurrencën e biznesit dhe diskriminimin. Shumë nga këto sfida janë në nivel individual, komuniteti dhe shoqëror.**

Në nivel individual, pavarësisht menaxhimit të biznesit dhe trajnimeve të tjera që marrin të mbijetuarit(at) përpara se të hapin biznesin e tyre, **javët e para të një biznesi të ri mund të jenë shumë të vështira.** Siç ilustron nga citimi më poshtë, të kuptuarit se i mbijetuari është i vetëm përgjegjës për menaxhimin e buxhetit, porositjen e furnizimeve dhe gjetjen e klientëve fillimisht mund të jetë shumë.

“Të duhet të menaxhosh gjithçka vetë, si shpenzimet, qiratë, faturat, furnizimet; dhe kjo nuk është e lehtë sepse nëse nuk marr furnizime të mjaftueshme, dyqani do të duket bosh. Gjërat bëhen më të lehta me kalimin e kohës, veçanërisht nëse punon fort, **por fillimi është gjithmonë i vështirë.**”

#### E mbijetuar femër

Kjo sugjeron që profesionistët e shërbimeve duhet të ofrojnë mbështetje intensive për të mbijetuarit(at) në javët e para të fillimit të biznesit të tyre të ri. Një mbështetje e tillë duhet të vijë në formën e këshillimit, udhëzimeve për të menaxhuar blerjen e furnizimeve dhe këshilla për menaxhimin e buxheteve.



Në nivel komuniteti, intervistat individuale dhe diskutimet në grupe të fokusuara theksuan se trajnimi që të mbijetuarit(at) marrin në qendrat shtetërore të formimit profesional nuk i përgatit të mbijetuarit(at) për të hapur biznesin e tyre. Ky shqetësim u ngrit nga OJQ-ja Të ndryshëm dhe Të barabartë në një raport të vitit 2018.<sup>52</sup> Raporti theksoi se, megjithëse në kurset e formimit profesional janë futur disa koncepte për të mësuarit mbi sipërmarrjen, nuk ofrohet asnjë trajnim serioz për sipërmarrjen në drejtim të vetëpunësimit apo hapjes së një biznesi të ri. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme duke qenë se pothuajse të gjitha (96%) bizneset në Shqipëri janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme.<sup>53</sup>

**Gjithashtu në nivel komuniteti, një sfidë kryesore për të mbijetuarit(at) që duan të hapin biznesin e tyre është mungesa e kapitalit fillestar.** Kur një biznes mund të menaxhohet nga shtëpia, i mbijetuari kërkon vetëm një sasi të vogël kapitali për të blerë pajisje dhe materiale. Megjithatë, të mbijetuarit(at) mund të mos kenë para për të blerë edhe këto sende. Për ata që kanë nevojë të marrin me qira një zyrë ose hapësirë tjetër ku të zhvillojnë biznesin e tyre, kërkohet më shumë kapital fillestar. Mungesa e kapitalit është veçanërisht problematike për të mbijetuarit(at) që dëshirojnë të jetojnë dhe të menaxhojnë biznesin e tyre në qytetet kryesore si Tirana, ku qiraja dhe kostot e tjera janë më të larta.

“Mungesa e kapitalit fillestar është mjaft problematike sepse nuk mund të blihen furnizimet, që do të thotë se nuk ke asgjë për të shitur. Nëse nuk ke asgjë për të shitur, nuk ke asnjë fitim. Nëse shet pak, fiton pak.”

#### E mbijetuar femër

Në nivel shoqërie, një sfidë për të mbijetuarit(at) që hapin biznesin e tyre është konkurrenca. Pavarësisht vlerësimeve të tregut që po ndërmerren, pas hapjes së një biznesi, i mbijetuari mund të përballë me konkurrencë të ashpër dhe pak klientë. Për më tepër, edhe për bizneset me disa klientë, të ardhurat e krijuara mund të mos jenë të mjaftueshme për t'i mbajtur ata.

“Unë fillova t'i bëja thonjtë me 500<sup>54</sup> lek, po çfarë mund të bësh me 500 lek?”

#### E mbijetuar femër

**Studimi identifikoi se si rezultat i konkurrencës së biznesit dhe të ardhurave të ulëta, të mbijetuarit(at) mund të stresohen gjithnjë e më tepër. Kjo mund të tjetërsojë çdo përfitim të akumuluar të shëndetit mendor dhe të çojë në nevojën për mbështetje shtesë të të mbijetuarit(at) nga profesionistët e shërbimeve dhe, ndoshta, këshillim për të eksploruar opsione të tjera biznesi ose punësimi.** Kjo përsëri thekson rëndësinë e vazhdimin të mbështetjes për riintegrim ndërkohë që të mbijetuarit(at) janë të angazhuar në biznesin e tyre të ri.

**Në nivel komuniteti, një sfidë është se të mbijetuarit(at) që hapin biznesin e tyre mund të përjetojnë**

<sup>52</sup> Të ndryshëm dhe të barabartë, (“Kërkim mbi aftësitë dhe mundësitë e tregut lokal të punës për të mbështetur fuqizimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit dhe dhunës në familje në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë”), ‘[Re-search on local job market skills and opportunities to support the economic empowerment of survivors of trafficking and domestic violence in Tirana, Kukës, Dibra and Saranda](#)’. Nëntor 2018, f. 40.

<sup>53</sup> Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014-2020.

<sup>54</sup> GBP3.45 (konvertimi i monedhës më 31 mars 2022).

**stigmë**, e cila mund të pengojë aftësinë e tyre për të gjetur klientë të rinj dhe për të gjeneruar të ardhura të mira. E mbijetuara, e cila kishte hapur biznesin e saj të riparimit të automjeteve, raportoi se ishte përballur me diskriminim të konsiderueshëm nga furnitorët vendas, të cilët ishin udhëzuar nga bizneset e konsoliduara të riparimit të automjeteve që të mos i shisnin asaj, duke dashur që biznesi i saj të dështonte. Sidoqoftë, biznesi i kësaj të mbijetuarë lulëzoi pasi ajo gjeti një furnizues që i shiste asaj materiale (megjithëse me një kosto më të lartë) dhe ajo vazhdoi të rriste bazën e saj të klientëve.

**Studimi identifikoi se disa nga sfidat e vetëpunësimit janë unike për të mbijetuarit(at) e trafikimit.** Për shembull, të mbijetuarit(at) nuk mund të kryejnë një biznes nga shtëpia kur klientët (të panjohur) vijnë në shtëpi për qëllime biznesi. Ndërsa menaxhimi i një biznesi parukerie ose manikyr-pedikyri mund të duket i thjeshtë, hyrja e personave të panjohur në shtëpinë e tyre mund të krijojë shqetësime të lidhura me sigurinë.

“Unë i kam aftësitë e nevojshme, por më duhet të kem klientë dhe një hapësirë. **Unë nuk mund të lejoj që në shtëpinë time të futet kushdo.**”

### E mbijetuar femër

**Të mbijetuarit(at) e trafikimit janë gjithashtu unikë kuptimin që nuk janë në gjendje të marrin hua aq lehtë sa individët e tjerë.** Ata mund të jenë mashtruar më parë në punë shfrytëzuese për shkak të një borxhi artificial, ose të jenë të vetëdijshëm se marrja e një kredie mund t'i bëjë ata të cenueshëm ndaj punësimit shfrytëzues për të paguar huanë. Në këtë mënyrë, nëse biznesi i një të mbijetuarit po dështon, ata normalisht do të konsideronin gjenerimin alternativ të të ardhurave që nuk përfshin marrjen hua të parave nga bankat ose individët.

Ekzistojnë rreziqe dhe pasoja negative që lidhen me paaftësinë e një të mbijetuarit për të mbajtur me sukses biznesin e tyre. Ata që nuk janë në gjendje, për arsye të ndryshme, të mbajnë vendin e punës dhe bizneset e të cilëve nuk janë të suksesshme, mund të përjetojnë zhgënjim dhe dëshpërim nga paaftësia e tyre për të gjeneruar të ardhura dhe për të siguruar të ardhura për familjen e tyre. Një biznes i dështuar mund të ketë thithur çdo kursim, duke e bërë individin të ndiejë se duhet të gjejë shpejt burime të tjera të ardhurash. Profesionistët e shërbimeve luajnë një rol të rëndësishëm për këshillimin e një të mbijetuarit për të marrë parasysh ide të tjera biznesi dhe punësimi, duke ndërtuar besimin e tyre për të ndjekur mundësi të tjera ekonomike dhe duke i lidhur të mbijetuarit(at) me shërbime të tjera mbështetëse.

## 5.4 Shërbime të tjera që mbështesin riintegrimin ekonomik

**Studimi identifikoi se riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve të trafikimit përmes formimit profesional, praktikave, vendosjes në punë dhe mbështetjes për të hapur një biznes nuk ndodh i izoluar.** Shërbime të tjera të rëndësishme mbështetëse që u theksuan nga intervistat dhe pjesëmarrësit në diskutime në grupe të fokusuara përfshijnë arsimin, kujdesin shëndetësor, strehimin dhe ndihmën ekonomike. Ky seksion i raportit eksploron këto shërbime dhe se si ato veprojnë si pararendës dhe faktorë mbështetës për mbështetjen për riintegrimin ekonomik. Duhet të theksohet se ndihma juridike është e rëndësishme për riintegrimin, por për shkak se ajo është përmendur pak në intervista dhe në diskutime në grupe të fokusuara, ajo nuk diskutohet në gjetjet e raportit.

## Arsimi

Veçanërisht për të mbijetuarit(at) më të rinj, arsimimi është një pjesë thelbësore e riintegritimit, duke përfshirë riintegrimin ekonomik. Pesë nga 14 të mbijetuarit(at) e intervistuar (36%) ishin, në kohën e intervistës, të regjistruar në shkollë të mesme dhe dy (14%) në universitet. Pra, **50 për qind e të mbijetuarve të intervistuar ishin të angazhuar në arsim në kohën e intervistës.** Megjithatë, shtatë të mbijetuarit(at) e tjerë nuk kishin mbaruar shkollën e mesme dhe raportuan se nuk kishin plane për shkollim.

Studimi identifikoi se **mbështetja me arsim është kritike për riintegrimin ekonomik. Të mbijetuarit(at) e rinj që mbështeten për të përfunduar shkollën e mesme kanë një shans më të madh për të gjetur një punë të denjë sesa ata që nuk kanë përfunduar shkollën e mesme dhe ata që kanë përfunduar arsimin e lartë kanë një shans edhe më të madh për të gjetur punë të denjë profesionale.**

“Arsimi është çështja më e rëndësishme për momentin, sepse i jam kthyer shkollës pas shumë viteve shkëputjeje dhe **pas shumë përpjekjesh nga punonjësi social, i cili vazhdimisht më pyeste nëse doja të kthehesha në universitet.** Këtë vit më në fund e vendosa. Këtë vit isha e vendosur dhe do ta përfundoj sepse është shumë e rëndësishme.”

## E mbijetuar femër

Ka pengesa që të mbijetuarit(at) të kthehen në shkollën e mesme ose të mendojnë të regjistrohen në arsimin e lartë. Në nivel individual, një pengesë kryesore për disa të mbijetuar për t'u reregjistruar në arsim është mosha e tyre. Të mbijetuarit(at) që janë në të njëzetat ose të tridhjetat e tyre mund të pendohen që nuk kanë përfunduar shkollën e mesme, por mendojnë se është shumë vonë që ata të përpiqen të studiojnë më tej. Një tjetër pengesë për reregjistrimin në arsim në nivel individual dhe komunitar është gjendja financiare. Të mbijetuarit(at) që jetojnë në komunitet (jo në një strehëz) duhet të paguajnë qiranë dhe shërbimet e tjera bazë dhe, për rrjedhojë, mund të kenë përparësi gjetjen e punës dhe jo studimin.

## Kujdesi shëndetësor

Disa të mbijetuar të intervistuar raportuan se tejkalimi ose menaxhimi i çështjeve mjekësore ishte thelbësor për rimëkëmbjen dhe riintegrimin e tyre të përgjithshëm. Në mënyrë të ngjashme, intervistat dhe diskutimet në grupe të fokusuara me profesionistët theksuan se, të paktën, menaxhimi i çështjeve shëndetësore është i rëndësishëm për riintegrimin ekonomik. Kur të mbijetuarit(at) janë të sëmurë, ata do ta kenë të vështirë të gjejnë një punë dhe ta mbajnë atë. Prandaj, menaxhimi i sfidave shëndetësore është thelbësor përpara se të mbijetuarit(at) të angazhohen në punësim me kohë të plotë ose të hapin biznesin e tyre.

Qendra kombëtare dhe strehëzat e menaxhuara nga OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm për ofrimin e këshillave për të mbijetuarit(at) mbi shërbimet shëndetësore më të përshtatshme për ta dhe shpeshherë i transportojnë të mbijetuarit(at) drejt dhe nga shërbimet shëndetësore. Në momentin kur i mbijetuari shpëtohet ose i ka shpëtuar një situatë trafikimi, atij ose asaj i ofrohet kujdes shëndetësor urgjent. Megjithatë, disa të mbijetuar kanë nevojë të vazhdueshme shëndetësore që kërkojnë vizita të rregullta ose të herëpashershme në spitale ose klinika dhe ndonjëherë edhe kujdes të specializuar.

Studimi identifikoi se, sipas legjislacionit kombëtar,<sup>55</sup> të mbijetuarve të mundshëm të trafikimit, të cilët përbëjnë përqindjen më të madhe të të mbijetuarve të identifikuar, nuk u ofrohet kujdes shëndetësor falas. Një sfidë e ndërlikuar është se aksesimi në kujdesin shëndetësor falas vazhdon vetëm derisa të mbijetuarit(at) potencialë të kenë statusin zyrtar të të mbijetuarit(at), ndërsa, siç konfirmohet edhe nga ky raport, kujdesi i shëndetësor ndaj tyre pa dyshim që duhet të vazhdojë për një kohë të gjatë. Megjithatë të mbijetuarit(at) mund të përfitojnë nga i njëjti legjislacion kur regjistrohen si të papunë, kjo do të nënkuptonte më shumë punë në letër dhe akses në zyra të tjera. Një sfidë tjetër është se të mbijetuarit(at) marrin kujdes të specializuar shëndetësor vetëm kur marrin një referim nga mjeku i tyre i përgjithshëm (mjeku i familjes). Është e mundur që disa të mbijetuar, veçanërisht ata që janë trafikuar për shfrytëzim seksual, të mund të hezitojnë t'i drejtohen mjekut të përgjithshëm për një referim të kujdesit shëndetësor për shkak të stigmës. Së fundi, ka pak qendra të trajtimit të abuzimit me substancat në Shqipëri dhe të intervistuarit në këtë studim nuk kishin dijeni lidhur me ndonjë qendër të tillë të specializuar.

Shumë të mbijetuar të trafikimit të qenieve njerëzore vuajnë nga çrregullime të vazhdueshme të shëndetit mendor, përfshirë edhe traumat. Për rrjedhojë, kujdesi cilësor ndaj shëndetit mendor ka rëndësi të madhe për rimëkëmbjen dhe riintegrimin e tyre. Jo të gjithë të mbijetuarit(at) e intervistuar po merrnin kujdes të shëndetit mendor në kohën e intervistës. Dy prej tyre raportuan se kishin marrë këshillim dhe kujdes tjetër të specializuar për shëndetin mendor më përpara, por nuk kishin më nevojë për të. Ata ishin të vetëdijshëm se në strehëz ose në qendrën që i mbështet ata ofrohet këshillim dhe mbështetje psikologjike, nëse ata vendosin se kanë nevojë për të.

“Nëse ata janë duke kaluar një krizë, takimet janë më të shpeshta. Më shumë vëmendje i kushtohet punës mbi gjendjen, stabilizimit të gjendjes emocionale dhe vazhdimin me fazat e tjera, për të punuar me traumën, post-traumën apo problemet që shfaqin. Në përgjithësi, seancat janë të rregullta. Ndonjëherë ato mund të jenë më të shkurtra, ndonjëherë më të gjata, në varësi të llojit të nevojës që kanë.”

### Profesionist

Studimi identifikoi se është e rëndësishme që të mbijetuarit(at) të mos fillojnë trajnimin profesional ose punësim derisa të jenë të përgatitur mendërisht për ta bërë këtë. Siç sugjeron citimi më poshtë, kujdesi për shëndetin mendor duhet të paraprijë trajnimin profesional.

“Ne nuk mund të flasim rreth trajnimit pa stabilizuar më parë gjendjen shëndetësore.”

Profesionist

Kishte konsensus në intervistat dhe FGD-të se **mbështetja cilësore ndaj shëndetit mendor është parësore për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve**. Pa mbështetje të vazhdueshme për t'u shëruar nga trauma, ata do të përjetojnë sfida në nivel individual për të mbajtur vendin e punës, vështirësi për t'u përballur me orët e gjata të punës, mërzë në punë, ndërveprim me klientët, stigmë (nga kolegët dhe të tjerët) dhe stress për menaxhimin e financave të biznesit.

<sup>55</sup> Ligji nr. 10 383, 2011, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

“Unë mendoj se shëndeti mendor është shumë i rëndësishëm; nëse je i shëndetshëm psikologjikisht, të gjitha të tjerat rregullohen. Nëse nuk je i qetë dhe i përqendruar në atë që dëshiron të bësh, atëherë nuk mund të jetosh në paqe sepse je duke luftuar me gjëra të tjera. Pra, shëndeti mendor vjen i pari, dhe të gjitha të tjerat rregullohen më pas.”

### E mbijetuar femër

Intervistat dhe grupet e fokusuar me profesionistët e shërbimeve theksuan se mbështetja ndaj shëndetit mendor duhet të jetë e vazhdueshme gjatë gjithë riintegritit ekonomik të të mbijetuarit(at). Të mbijetuarit(at) që janë të angazhuar në arsim, punë ose biznes duhet të vazhdojnë të marrin të paktën seanca këshillimi psikosocial në mënyrë që të ruajnë përparimin e arritur në lidhje me shëndetin mendor dhe të menaxhojnë çdo stres të lidhur me arsimin ose me punën.

“Është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse ti duhet të jesh mendërisht i fortë dhe i shëndetshëm në mënyrë që të punësohesh dhe të fillosh të punosh diku.”

### E mbijetuar femër

Në nivel shoqërie, një sfidë kryesore e raportuar nga profesionistët dhe pjesëmarrësit në grupet e fokusuar është mungesa e kujdesit të specializuar për shëndetin mendor në Shqipëri. Ndërsa në Shqipëri sigurisht që ka shërbime të tilla, ka një mungesë të përgjithshme të kujdesit të specializuar për shëndetin mendor, veçanërisht në zonat rurale të vendit dhe për fëmijët dhe adoleshentët. Kujdesi shëndetësor mendor në Shqipëri duket se po shkon drejt një rrjeti të integruar shërbimesh që ofron trajtim shëndetësor, rehabilitim dhe integrim social të individëve që kanë nevojë për kujdes të shëndetit mendor. Megjithatë, deri më sot nuk ka asnjë rezultat konkret që të tregojë se ky vizion është bërë i prekshëm.<sup>56</sup>

Intervistat dhe grupet e fokusuar konfirmuan se këshillimi psikosocial menaxhohej nga psikologët e trajnuar në strehëza ose qendra dhe, në këtë mënyrë, ka një vazhdimësi të kujdesit të ofruar brenda strehëzës.

“Për të qenë i sinqertë, ne mund të ofrojmë vetëm mbështetje të përgjithshme të kujdesit të shëndetit mendor. Dhe kjo situatë nuk vlen vetëm për ne, por është e njëjtë në të gjithë Shqipërinë. Kjo është thembra e Akilit dhe është ajo që nuk funksionon. Nuk ka shërbime të specializuara të shëndetit mendor për fëmijët. Nuk ka terapi mbështetëse me metadon, për shembull. Vetëm imagjinoji se çfarë mund të bëjë një person i stafit në mes të natës me raste të tilla. Por kështu janë pothuajse të gjitha rastet që na referohen. Ato vijnë me trauma ose situatë post-traumatike.”

**Profesionist**

<sup>56</sup>. Ministria e Shëndetësisë, ‘Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013–2022’ (në shqip), ‘[Action plan for the Development of Mental Health Services in Albania 2013–2022’ \(in Albanian\)](#). Shkurt 2013, f. 27.

Kjo sugjeron që Shqipëria duhet të vazhdojë të shtojë përpjekjet e saj për forcimin e sistemit të kujdesit të shëndetësor mendor. Aktualisht, të mbijetuarit(at) që vuajnë nga çrregullime akute të shëndetit mendor, si trauma të rënda ose varësia, nuk mund të kenë shërbimet e duhura, veçanërisht në zonat rurale. Për më tepër, ka shumë pak shërbime të specializuara të shëndetit mendor për fëmijët. Si rezultat, ka të ngjarë që riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve të ngecë si rezultat i mungesës së kujdesit të specializuar për të mbështetur rimëkëmbjen dhe riintegrimin e tyre të përgjithshëm

## Strehimi

**Strehimi u theksua në intervistat dhe grupet e fokusuara e kryera për këtë studim si një ndër shërbimet mbështetëse më të rëndësishme për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve.** Pa strehim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm, të mbijetuarit(at) ndihen shumë të shqetësuar dhe e kanë të vështirë të gjejnë punë dhe ta mbajnë atë.

“Unë mendoj se lloji më i rëndësishëm i mbështetjes është mbështetja për strehim.”

## E mbijetuar femër

Siç theksohet në Hyrje, të mbijetuarit(at) e trafikimit të qenieve njerëzore klasifikohen si grup përparësor sipas Ligjit 22/2018 “Për strehimin social”. Si rezultat i atij legjislacioni, janë krijuar disa programe për të mbështetur personat e cenusshëm, duke përfshirë edhe një program për strehimin e posaçëm për të mbijetuarit(at) e trafikimit. Megjithatë, pjesëmarrësit në intervistë raportuan se programi nuk është ende aktiv në Tiranë apo në zona të tjera të vendit dhe aktualisht nuk ka shtëpi të disponueshme.

“Programi i strehimit social ka disa shtëpi, por rastet tona nuk përfitojnë asnjëherë prej tij.”

## Profesionist

Të mbijetuarit(at) e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, si grup i cenusshëm, kanë gjithashtu të drejtën e përfitimit të bonusit shtetëror të strehimit. Sipas kësaj skeme, të mbijetuarit(at) e trafikimit (krahas të mbijetuarve të tjerë të dhunës) që janë të punësuar, por kanë të ardhura të kufizuara, mund të marrin një subvencion 100 për qind të qirasë. Të mbijetuarit(at) që kanë ca të ardhura mund të marrin 50 për qind të subvencionit. Intervistat individuale dhe diskutimet në grupe të fokusuara shpjeguan se shumica e bonusit të strehimit është opsionale, çfarë do të thotë se një komision diskuton rastin e secilit kërkues, duke vlerësuar, ndërmjet faktorëve të tjerë, edhe të ardhurat e tyre dhe numrin e fëmijëve. Kur miratohet bonusi i strehimit, bashkia i paguan qiradhënësit qiranë e të mbijetuarit(at).

Intervistat dhe grupet e fokusuara identifikuan se të mbijetuarit(at) shpesh përballen me shumë sfida në nivel të komunitetit në marrjen e bonusit të strehimit. Pas daljes nga strehëza, të mbijetuarit(at) mund të zgjedhin të jetojnë në një pjesë të Shqipërisë larg vendit ku kanë jetuar më parë. Kjo, të paktën në të shkuarën, ka çuar në probleme administrative me bashkitë, të cilat deklarojnë se të mbijetuarit(at) nuk mund të kenë akses në mbështetjen e strehimit në qytetin ku ata jetojnë rishtazi.

“Një problem tjetër madhor është se të mbijetuarit(at) e trafikimit të qenieve njerëzore nuk janë banorë të Bashkisë së Tiranës. Ata vijnë nga bashki të tjera. Që ata të mund të bëhen banorë të Tiranës, duhet një dokument pronësie që vërteton se jetojnë këtu. Vetëm atëherë këta persona kanë mundësinë të përfitojnë nga bonusi [i strehimit]. Nëse nuk bëhen banorë të Tiranës, nuk do të mund të përfitojnë asnjë nga këto shërbime. Mendoj se ky është problemi.”

**Profesionist**

Një sfidë tjetër në nivel komuniteti është se disa të mbijetuar që dëshirojnë të përfitojnë bonusin e strehimit duhet të tregojnë prova të një marrëveshjeje qiraje. Në Shqipëri, kjo është shpesh e vështirë të sigurohet, pasi shumë pronarë nuk duan të lidhin marrëveshje qiraje, për të shmangur pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja. Për rrjedhojë, mungesa e një marrëveshjeje qiraje i pengon të mbijetuarit(at) të aplikojnë për bonusin shtetëror të strehimit

“Presupozohet se ti jeton diku dhe nuk je në gjende të paguash qiranë. Por, në mënyrë që kjo të verifikohet, të duhet në kontratë qiraje, ose një dokument ligjor që provon atë që ti thua.”

**Profesionist**

Intervistat individuale dhe diskutimet në grupe të fokusuara sugjeruan se, për shkak të mungesës së një marrëveshjeje qiraje, dhe burokracisë së përgjithshme dhe proceseve të komplikuara të aplikimit, **pak të mbijetuar kanë arritur të kenë akses në bonusin shtetëror të qirasë.** Një profesionist i shërbimeve raportoi se vetëm një i mbijetuar në kujdesin e tyre kishte mundur të merrte bonusin e qirasë.<sup>57</sup>

“Bonusi i qirasë në pjesën më të madhe nuk ofrohet. Ka kaluar një vit i tërë dhe vetëm një i mbijetuar e ka marrë atë. Këtë vit nuk kemi pasur ende asnjë rast [të marrjes së bonusit të qirasë].”

**Profesionist**

Intervistat me të mbijetuarit(at) theksuan se mungesa e strehimit të mirë dhe të përballueshëm është shpesh shqetësimi i tyre më i madh. Mungesa e strehimit të qëndrueshëm kufizon aftësinë e tyre për të punuar ose studiuar dhe për të regjistruar fëmijët në shkollë ose në kujdesin ndaj fëmijëve. Stresi i lidhur me shqetësimin për mungesën e strehimit të mirë dhe të përballueshëm mund të ndikojë ndjeshëm edhe mbi shëndetin mendor të të mbijetuarve.

“Gjërat nuk po shkojnë mirë aktualisht, kanë marrë drejtimin për poshtë, sepse unë nuk jam në gjendje të gjej një shtëpi.”

**Female survivor**

<sup>57</sup> Ky konstatim mbështetet më tej përmes raportit të monitorimit të mëposhtëm: Mandro, A. dhe Rusi, N., “Monitorimi i ligjit 22/2018 Për Strehimin Social nga njësitë e qeverisjes vendore”. UNWOMEN, BE, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, 2021.

## Ndihma ekonomike

Studimi identifikoi gjithashtu ndihmën ekonomike si një shërbim kryesor që mbështet riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve. Të mbijetuarit(at) mund të përfitojnë ndihmë ekonomike prej 9,000 lekësh në muaj vetëm nëse kanë dalë nga strehëza, janë të papunë dhe kanë një deklaratë nga strehëza që mbështet pretendimin e tyre se janë të mbijetuar të trafikimit të qenieve njerëzore që kanë marrë mbështetje nga strehëza.

Nga intervistat evidentohet se jo të gjithë të mbijetuarit(at) janë në dijeni të kësaj ndihme ekonomike shtetërore. **Vetëm katër të mbijetuar (29%) raportuan se kanë marrë ndihmë ekonomike. Kjo sugjeron se ose të mbijetuarit(at) nuk janë në dijeni të ndihmës ekonomike të shtetit, ose nuk dëshirojnë të aplikojnë për të.** Raportohet se ka pasur gjithashtu një prirje rënëse vitet e fundit në numrin e të mbijetuarve të papunë që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike. Pjesëmarrësit në intervistë dhe diskutime në grupe të fokusuara raportuan se **burokracia shtetërore e bën të vështirë marrjen e ndihmës ekonomike.** Për më tepër, **masa e ndihmës ekonomike është e pamjaftueshme për të paguar qiranë dhe për gjëra të tjera thelbësore.** Më e rëndësishmja, të mbijetuarit(at) mund të përjetojnë diskriminim kur përpiqen të kenë akses në ndihmë ekonomike dhe i gjithë **procesi i aplikimit për ndihmë ekonomike nga qeveria mund të riviktimizojë të mbijetuarit(at) e trafikimit.** Të mbijetuarit(at) në thelb duhet të paraqiten në zyrën përkatëse të qeverisë dhe ti bëjnë një deklaratë stafit se janë të mbijetuar të papunë të trafikimit të qenieve njerëzore. Duke bërë këtë, ata mund të bëhen objekt stigme.

“Kemi atë ligjin e famshëm që një person ka të drejtë të marrë 3000<sup>58</sup> lekë nëse është i papunë. **Ka disa vite që të mbijetuarit(at) tanë përfitojnë nga kjo pagesë, pasi është e pamundur të lëshohen vërtetime pafund për të vërtetuar se janë të mbijetuar trafikimi. Personi diskriminohet; stigmatizohet.**”

### Profesionist

## 5.5 Diskutim: Efektet e faktorëve në nivelin individual, të marrëdhënies, komunitetit dhe shoqërisë mbi riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve

Ky raport diskutoi mbi mbështetjen e riintegrimin ekonomik, sfidat dhe mundësitë që lidhen me ofrimin ose aksesin në trajnime profesionale, praktikant, mundësitë e punësimit dhe mbështetjen për hapjen e një biznesi të vogël. Ai diskutoi gjithashtu rreth disa shërbimeve të tjera kryesore mbështetëse që, kur ofrohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, veprojnë si pararendës të rëndësishëm dhe faktorë mbështetës për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve. Këto shërbime përfshijnë arsimin, kujdesin shëndetësor, strehimin dhe ndihmën ekonomike. Ka faktorë të tjerë të rëndësishëm për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve që nuk përkojnë mirë në kategoritë e diskutuara më sipër, por që meritojnë diskutim të mëtejshëm. Këta janë faktorë në nivel individuale, marrëdhëniesh, komuniteti dhe shoqërie që shërbejnë për të lehtësuar ose penguar riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve dhe duhet të merren parasysh në kuadrin e ndikimit që ata kanë në atë rrugëtim.

### Faktorët në nivel individual

Jo të gjithë të mbijetuarit(at) e përjetojnë riintegrimin ekonomik pas trafikimit në të njëjtën mënyrë. **Faktorët e nivelit individual mund të ushtrojnë ndikim për këtë riintegrim.** Për shembull, **shëndeti mendor i një të mbijetuarit mund të ndikojë ndjeshëm në rimëkëmbjen dhe riintegrimin**

<sup>58</sup>. Në kohën e intervistës, masa e ndihmës ekonomike nuk ishte rritur ende në 9000 lekë.



**e tij/saj ekonomik.** Problemet e rënda të shëndetit mendor mund të ndikojnë negativisht mbi aftësinë për t'u rimëkëmbur nga trauma, për t'u angazhuar në punë me kohë të plotë me pagesë, për të studiuar ose për të krijuar marrëdhënie me kolegët dhe profesionistët e shërbimeve.

“Ndonjëherë ndihem krejt e vetme dhe në në errësirë.”

### E mbijetuar femër

Një tjetër faktor i nivelit individual që mund të ketë efekt negativ nbi riintegrimin ekonomik të një të mbijetuari është varësia. Disa të mbijetuar të trafikimit përjetojnë varësi të vazhdueshme nga droga dhe kjo mund të jëtë gjithashtu sfidë për të mbijetuarin në drejtim të gjetjes së punës dhe mbajtjes së saj, studimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve. Intervista individuale dhe diskutimet në grupe të fokusuara raportuan se **nuk ka shërbime të specializuara për varësinë në Shqipëri, përfshirë edhe qendrat e trajtimit të abuzimit me substancat.**

Studimi identifikoi se **faktorë të nivelit individual, të tilla si çështjet e shëndetit mendor dhe varësitë, mund të kontribuojnë që të mbijetuarit(at) të mos duan të marrin shërbimet e riintegritit ekonomik të ofruara nga profesionistët e shërbimeve.**

“Nuk u ndjeva gati sepse nuk e dija nëse mund t’u besoja. Kam folur shumë rrallë me punonjësen sociale timen. Sa herë që ajo më telefononte dhe më pyeste nëse kisha nevojë për ndonjë gjë, unë i thoja që nuk kisha nevojë. Isha shumë e tërhequr dhe nuk pranova të merrja asnjë lloj ndihme.”

### E mbijetuar femër

#### Faktorët në nivelin e marrëdhënieve

Intervistat theksuan se marrëdhëniet me familjet dhe miqtë janë të rëndësishme për riintegrimin ekonomik të një të mbijetuari. Ata që nuk kanë lidhje të ngushta me anëtarët e familjes, ose familja e të cilëve nuk është mbështetëse ose, edhe më keq, e ka bërë të mbijetuarin(ën) objekt shfrytëzimi ose stigmat për shkak të përvojës së tyre të trafikimit, do të përballen me pengesa të mëdha në drejtim të rimëkëmbjes dhe riintegritit ekonomik. Nga ana tjetër, **të mbijetuarit(at) që kanë një familje mbështetëse që i ndihmon ata të rikuperohen nga trauma dhe të (ri) fillojnë studimet, punën ose biznesin, janë në pozicion më të mirë për t’u rikuperuar dhe për të mbështetur jetesën e tyre të re.**

“Mund të ketë raste kur i mbijetuari ose e mbijetuara nuk ka ku të shkojë. E shihni personin që ka mbaruar shkollën e mesme, por ai ose ajo nuk ka familje, ose ndoshta jo një familje të papërshtatshme për t’u kthyer tek ajo. Kjo situatë mund të përbëjë rrezik për rritafikim të personit.”

**Profesionist**

Studimi identifikoi se është kritike që të mos jetë vetëm i mbijetuari që merr mbështetje për riintegrim ekonomik. Në rastet kur familja është në varfëri ose ka probleme të tjera social-

ekonomike, është e rëndësishme që profesionistët e shërbimeve të mbështesin të gjithë familjen. **Sigurimi i mbështetjes për të gjithë familjen e një të mbijetuar(e) në fund e ndihmon të mbijetuarin(ën) të riintegrohet**, nëse dëshiron ta bëjë këtë, në mjedisin familjar. Mund të zvogëlojë gjithashtu mundësinë që trafikimi në radhë të parë të mos ndodhë, si dhe rrezikun që vëllezërit e motrat e të mbijetuarit(at) ose anëtarët e tjerë të familjes të trafikohen.

“Fuqizimi ekonomik i të mbijetuarit(at) është i lidhur ngushtë me fuqizimin e familjes.”

## Profesionist

### Faktorët në nivelin e komunitetit

Faktorët në nivelin e komunitetit, të tillë si stigma, janë gjithashtu të rëndësishëm për riintegrimin ekonomik të një të mbijetuar. Përveç të mbijetuarve të trafikimit seksual, të mbijetuarit(at) lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjitorë, queer dhe interseks (LGBTQI) dhe ata nga pakicat kombëtare mund të përjetojnë stigmë të shtuar në nivel komuniteti. Studimi identifikoi se të mbijetuarit(at) mund të përjetojnë diskriminim nga anëtarët e familjes, fqinjët, punëdhënësit, klientët dhe, madje edhe profesionistët e shërbimeve.

**Të mbijetuarit(at) që përjetojnë stigmë në nivel komuniteti ka të ngjarë të përballen me sfida të mëdha lidhur me rimëkëmbjen dhe riintegrimin.** Ata mund të përjetojnë diskriminim dhe përjashtim social. Ata mund të përballen me vështirësi për të siguruar strehim të qëndrueshëm dhe punësim të denjë në komunitetin e tyre lokal dhe gjithashtu mund të përballen me sfida lidhur me krijimin e marrëdhënieve me punëdhënësit, fqinjët dhe njerëzit e tjerë. Ata që përballen me diskriminim nga komuniteti përreth mund të mendojnë se nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të zhvendosen në një zonë tjetër të Shqipërisë, ose të mendojnë të migrojnë jashtë shtetit.

**Në nivel komuniteti, mungesa e mundësive të punësimit dhe e shërbimeve sociale lokale mund të ketë një efekt negativ mbi riintegrimin ekonomik të një të mbijetuar(e).** Për shembull, nëse nuk ka mundësi të mira punësimi në komunitetin e të mbijetuarit(at)(ës), riintegrimi i tyre ekonomik mund të pengohet. Në mënyrë të ngjashme, nëse nuk ka mbështetje për strehim dhe pak mundësi strehimi të përballueshme në komunitet, të mbijetuarit(at) mund ta kenë të vështirë ta mbajnë punën, të regjistrojnë fëmijët në shkollë ose të kenë akses në shërbime të ndryshme mbështetëse lokale. Gjithashtu, më e rëndësishmja, mungesa e shërbimeve shëndetësore falas dhe cilësore mund të pengojë aftësinë e një të mbijetuar individual për t'u rimëkëmbur nga trauma ose nga varësia ndaj drogës. Kjo nënvizon rëndësinë e përmbushjes së mandateve nga bashkitë për të ofruar shërbime sociale për të gjithë individët e cenueshëm.

### Faktorët në nivelin e shoqërisë

Në nivel shoqërie, ekzistojnë një sërë faktorësh që ose mund të pengojnë, ose mund të lehtësojnë riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve. Për shembull, dhe siç theksohet në pjesën që flet për faktorët e nivelit të komunitetit, stigma luan një rol të rëndësishëm për riintegrimin e përgjithshëm të një të mbijetuar(e), duke përfshirë edhe riintegrimin ekonomik. Studimi identifikoi se stigma e nivelit të shoqërisë ndaj të mbijetuarve të trafikimit, veçanërisht atyre që kanë përjetuar trafikim për shfrytëzim seksual, është një çështje shqetësuese në Shqipëri. Si të mbijetuarit(at), edhe profesionistët që morën pjesë në intervistat për këtë studimin theksuan se të mbijetuarit(at) e

trafikimit shpesh përballen me stigmë kur regjistrohen dhe marrin studime, trajnime profesionale ose punësim, ose hapin një biznes të ri. Gjatë intervistave individuale dhe diskutimeve në grupe të fokusuara me të mbijetuarit(at) dhe profesionistët, u ndanë shumë histori në lidhje me diskriminimin. Të mbijetuarit(at) dhe profesionistët raportuan se të mbijetuarit(at) shpesh përballen me stigmë kur përpiqen të aksesojnë shërbimet shtetërore, të tilla si punësimi dhe mbështetja financiare. Ata mund të nënçmohen, të bëhen të ndihen inferiorë, të quhen gënjeshtarë dhe t'u mohohet çdo ndihmë. Ky konstatim nxjerr në pah nevojën për rritje të përpjekjeve për të forcuar njohuritë dhe ndërgjegjësimin e të gjithë shqiptarëve, përfshirë profesionistët e shërbimeve, mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe të drejtat e të mbijetuarve të trafikimit për shërbime mbështetëse.

Gjithashtu në këtë nivel, **proceset burokratike shtetërore janë një faktor kryesor që pengon aftësinë e të mbijetuarve për të aksesuar ndihmën për punësim dhe ndihmën ekonomike.** Pati konsensus në intervistat e kryera me të mbijetuarit(at) dhe profesionistët për studimin aktual se këto procese janë aq të ndërlikuara dhe të gjata sa që shumë të mbijetuar as që përpiqen të kenë akses në shërbimet shtetërore. Disa të mbijetuar mund të përpiqen për shumë muaj të kenë akses në mbështetjen nga shteti (p.sh., mbështetje ekonomike për të papunët ose bonusin e strehimit) dhe në fund heqin dorë sepse e kanë të vështirë të përmbushin kriteret ose nuk mund të mbledhin dokumentet. Të mbijetuarit(at) e tjerë më në fund mund të jenë të suksesshëm për arritjen e një ndihme shtetërore, por, për shkak të kërkesave të vazhdueshme (minimalisht çdo vit) për dokumentacion, ata mund të vendosin të mos vazhdojnë të kenë akses në mbështetje.

Në nivel shoqërie, **mungesa e fondeve për shërbimet shtetërore ka gjithashtu pasoja negative për të mbijetuarit(at).** Legjislacioni dhe dokumentet e politikave udhëzojnë, të paktën në letër, ofrimin e shërbimeve shtetërore të riintegritit ekonomik për të mbijetuarit(at) e trafikimit. Megjithatë, **buxheti kufizon aftësinë e disa agjencive për të zbatuar mandatin e tyre.** Intervistat individuale dhe diskutimet në grupe të fokusuara theksuan se mbështetja shtetërore, veçanërisht në nivel bashkie, është disi *ad hoc*, me disa bashki që ofrojnë mbështetje ekonomike për të mbijetuarit(at) në kohë të caktuara kur bashkia ka fonde, por jo në raste të tjera. Kjo i bën profesionistët e shërbimeve që t'u drejtohen agjencive shtetërore me kërkesa *ad hoc* për mbështetje për të mbijetuarit(at), disa prej të cilave miratohen, ndërsa të tjerat jo. Me fjalë të tjera, nuk ka konsistencë të përgjithshme për mbështetjen e riintegritit ekonomik në nivel bashkie për të mbijetuarit(at) e trafikimit.

"Ato (zyrat e bashkisë) janë përkrahëse, por nuk kanë forcë për t'i bërë të gjitha. Ato nuk janë funksionale aq sa duhet; atyre u mungon financimi i duhur. Bashkia mund të ketë një mori sfidash të brendshme: mund ta ketë të vështirë edhe të mbulojë pagat e saj; dhe ky është një problem në bashkitë e mëdha, mendoni bashkitë më të vogla që vërtet e kanë të vështirë të paguajnë stafit të tyre, e lëre më të japin shërbime."

**Key informant interview participant**

Gjithashtu në këtë nivel, **mungesa e mundësive për punësim të denjë për të mbijetuarit(at) e trafikimit, si dhe për qytetarët dhe banorët e tjerë, kufizon në masë të madhe aftësinë e profesionistëve të shërbimeve për të mbështetur të mbijetuarit(at) për të arritur qëllimet e tyre të punësimit.** Në shumicën e rasteve, mund të ofrohen vetëm opsione specifike të formimit profesional, thjesht sepse bërja e trajnimeve jashtë atyre fushave është ose përtej mundësive të të mbijetuarve (për shkak të mungesës së arsimit dhe faktorëve të tjerë), ose sepse trajnimi ka të ngjarë të mos çojë në punësim të denjë dhe afatgjatë.

“Riintegrimi në shoqërinë shqiptare është i vështirë. Është i vështirë për një njeri normal që ka humbur punën, ose për dikë që është kthyer nga emigracioni, ose për dikë që është i arsimuar, por prapë nuk mund të gjejë punë. Pra, së pari nuk ka vende të lira pune dhe, së dyti, nuk ka vende të sigurta pune. Ndërkohë kompensimi është shumë i vogël dhe i pamjaftueshëm për mbijetesë.”

Profesionist

Së fundi, një problem tjetër në nivel shoqëror në Shqipëri është **se ka një mungesë të përgjithshme të koordinimit për ofrimin e riintegritit ekonomik dhe shërbimeve të tjera për të mbijetuarit(at) e trafikimit**. Për shkak të mungesës së koordinimit, referimi i një të mbijetuarit(e) ndërmjet agjencive përkatëse mund të pengohet, për rrjedhojë të mbijetuarit(at) duhet të presin periudha të gjata për ofrimin e shërbimit. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse dhe profesionistëve do të thotë gjithashtu se ka mundësi të zvogëluara për të trajtuar çështjen e diskriminimit të profesionistëve të shërbimeve ndaj të mbijetuarve të trafikimit.

“Askush nuk i ofron këto shërbime vetëm. Nuk ka asnjë organizatë apo institucion që i kryen të gjitha punët vetë. Për të ofruar shërbime riintegrimi, **duhet që të gjithë aktorët të jenë të pranishëm në tryezë.**”

Profesionist

# 6

**Përfundime dhe  
hapat pasuese**

## 6. Përfundime dhe hapat pasuese

Ky raport ofron njohuri të rëndësishme mbi mbështetjen për riintegrimin ekonomik që u ofrohet të mbijetuarve të trafikimit dhe mbi sfidat me të cilat ata dhe profesionistët e shërbimeve përballen për të pasur akses ose për të ofruar, përkatësisht, mbështetje cilësore dhe të qëndrueshme. Studimi identifikon se një gamë mbështetjesh të tilla ofrohet nga profesionistët të shërbimeve në Shqipëri, duke përfshirë trajnimin profesional dhe praktikën, mbështetjen për punësim dhe hapjen e një biznesi të ri. Përveç kësaj, të mbijetuarit(at) kanë mundësi të kenë mbështetje në fusha të tjera të rëndësishme, të tilla si arsimi, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe ndihma ekonomike, të cilat janë pararendëse dhe faktorë të rëndësishëm për riintegrimin ekonomik të tyre.

Në fushën e **formimit profesional**, studimi identifikon se është e rëndësishme për riintegrimin e tyre ekonomik që të mbijetuarit(at) të marrin informacion për mundësitë e formimit profesional dhe të jenë në gjendje të marrin vendime në lidhje me trajnimin që dëshirojnë të marrin. Është gjithashtu e rëndësishme që këto opsione të paraqitura për të mbijetuarit(at) të jenë ato që ka të ngjarë të çojnë në punësim të mirë dhe mundësi biznesi. Është më tej e rëndësishme që opsionet e formimit profesional të përputhen me nivelin e arsimimit të të mbijetuarve, me mundësitë e punësimit dhe biznesit, për të siguruar që ata të jenë në gjendje të gjejnë punë të denjë pas përfundimit të formimit profesional. Për më tepër, formimi profesional duhet të përfshijë komponentë mbi përmirësimin e aftësive për jetën dhe menaxhimin e biznesit. Certifikatat janë gjithashtu të rëndësishëm, pasi ato sigurojnë prova se një i/e mbijetuar ka fituar aftësi punësimi dhe e bën më të lehtë gjetjen e një pune për ta.

Studimi nënvizon më tej se rruga nga formimi profesional drejt punësimit ose hapjes së një biznesi nuk është domosdoshmërisht lineare dhe mbështetja për riintegrimin ekonomik nuk duhet të përfundojë në fazën e punësimit. Është e rëndësishme që profesionistët e shërbimeve të ndjekin ciklin e plotë të këshillimit, duke i ofruar të mbijetuarve të eksplorojnë një sërë mundësish formimi profesional, ndërsa mbështeten gjatë gjithë kohës me këshillim.

Për sa i përket sfidave që lidhen me aksesin ose ofrimin e trajnimit profesional cilësor, studimi identifikon se të mbijetuarit(at) me fëmijë të vegjël e kanë shumë të vështirë të angazhohen në trajnimin profesional në rastet kur kanë akses të kufizuar në shërbimet falas ose të përballueshme të kujdesit për fëmijët. Ndërkohë që kujdesi për fëmijët nuk ishte një shërbim që u eksplorua shprehimisht në intervista ose diskutime në grupe të fokusuara për këtë studim, sfida e mungesës së kujdesit për fëmijët u ngrit disa herë gjatë mbledhjes së të dhënave cilësore. Studimi më tej identifikon se formimi profesional është i vështirë për t'u aksesuar për të mbijetuarit(at) që jetojnë në zonat rurale të vendit. Për më tepër, qendrat e trajnimit profesional shpesh kanë mungesë të burimeve dhe trajnimi i ofruar për të mbijetuarit(at) është shpesh i pamjaftueshëm për të përgatitur të trajnuarit për punësim.

Për sa i përket **praktikave profesionale dhe mbështetjes për punësim**, studimi identifikon se praktikat profesionale janë një rrugë e vlefshme drejt punësimit të denjë, por thekson se është e rëndësishme që praktikantët të paguhen. Procesi i marrjes së pagesave të rregullta të pagave i ndihmon të mbijetuarit(at), veçanërisht ata që nuk kanë punuar më parë, të mësohen të marrin të ardhura të rregullta nga punëdhënësi i tyre dhe rrit aftësitë e tyre të menaxhimit të buxhetit dhe besimin e përgjithshëm për të hyrë në tregun e punës. Studimi më tej identifikon se praktikat profesionale janë një mundësi e rëndësishme për të mësuar, e cila duhet t'i paraprijë punësimit për të mbijetuarit(at) që nuk kanë punuar më parë. Është e rëndësishme që kompanitë të verifikohen përpara se të punësojnë të mbijetuarit(at) si praktikantë. Studimi identifikon gjithashtu disa përpjekje pozitive të institucioneve përkatëse për të ofruar mbështetje për punësim për të mbijetuarit(at), ku shumë të mbijetuar në kampionin e studimit kanë gjetur punë në fushën ku janë trajnuar, ndërsa të tjerët kanë marrë mbështetje punësimi nga AKPA-ja.

Studimi identifikon disa sfida, në nivele të ndryshme, për të mbijetuarit(at) dhe profesionistët e shërbimeve përkatësisht për të pasur akses ose për të ofruar mbështetje cilësore për punësim dhe sfida për të mbijetuarit(at) për të nisur një punë dhe për ta mbajtur atë. Studimi identifikon se pa përgatitjen e nevojshme përmes formimit profesional dhe të aftësive për jetën dhe mbështetjes së vazhdueshme nga profesionistët e shërbimeve dhe punëdhënësit, gjetja e punës mund të jetë një përvojë dërrmuese për disa të mbijetuar. Mungesa e kujdesit falas për fëmijët pengon aftësinë e të mbijetuarave për të pasur një punë të denjë. Në nivel shoqërie, një sfidë kryesore për të mbijetuarit(at) për të gjetur një punë të denjë është se ka pak mundësi punësimi në Shqipëri. Në këtë nivel, një sfidë e madhe për mbajturi punën është se, në disa raste, paga është shumë e ulët për të mbijetuarit(at) për të paguar qiranë dhe për të përballuar shërbimet e tjera bazë. Gjithashtu, për këtë nivel, intervistat evidentuan se jo të gjithë të mbijetuarit(at) gjejnë punë pas regjistrimit në AKPA. Shumë prej tyre presin një kohë të gjatë pasi të dorëzojnë kërkesën për mbështetje për punësim për t'u ofruar punë. Gjithashtu në nivel shoqërie, disa të mbijetuar(a) përrjetojnë stigmë kur angazhohen me stafin e zyrës së AKPA-së.

Për sa i përket **mbështetjes për të hapur një biznes**, studimi identifikon se fillimi i një biznesi mund të jetë një përvojë shumë fuqizuese për të mbijetuarit(at). Nëpërmjet formimit profesional dhe menaxhimit të biznesit, të mbijetuarit(at) fitojnë aftësi të menaxhimit të biznesit dhe financave, të cilat më pas zbatohen përmes krijimit dhe menaxhimit të biznesit.

Studimi identifikon se të mbijetuarit(at) gjithashtu përballen me sfida lidhur me hapjen dhe mbajtjen e biznesit të tyre. Për shembull, mungesa e kapitalit fillestar është veçanërisht problematike për ata që dëshirojnë të jetojnë dhe të menaxhojnë biznesin e tyre në qytete të mëdha si Tirana, ku qiraja dhe kostot e tjera janë të larta. Pavarësisht realizimit të vlerësimeve të tregut, pasi ka nisur një biznes, i mbijetuari ose e mbijetuara mund të përballen prapëseprapë me konkurrencë të ashpër biznesi dhe me pak klientë. Në nivelin e komunitetit dhe shoqërisë, një sfidë është që të mbijetuarit(at) që hapin biznesin e tyre mund të përrjetojnë stigmë dhe kjo mund të pengojë aftësinë e tyre për të gjetur klientë të rinj dhe për të mbledhur të ardhura të mira. Studimi më tej identifikon se disa nga sfidat e vetëpunësimit të përjetuara janë unike për të mbijetuarit(at) e trafikimit. Për shembull, të mbijetuarit(at) nuk mund të kryejnë një biznes nga shtëpia e tyre kur kjo përfshin klientë (të panjohur) që vijnë në shtëpinë e tyre për qëllime biznesi. Të mbijetuarit(at) e trafikimit përbëjnë gjithashtu një grup unik në kuptimin që nuk janë në gjendje të marrin kredi financiare aq lehtë sa individët e tjerë.

**Lidhur me shërbimet e tjera mbështetëse**, studimi identifikon se arsimit, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe ndihma ekonomike janë kritike për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve. Të mbijetuarit(at) e rinj/reja që mbështeten për të përfunduar shkollën e mesme kanë një shans më të mirë për të gjetur një punë të denjë sesa ata që nuk përfundojnë shkollën e mesme. Megjithatë, një pengesë e madhe për reregjistrimin e disa të mbijetuarve në sistemin arsimor është mosha e tyre. Ata që janë në të njëzetat ose të tridhjetat e tyre mund të jenë 'pënduar' që nuk kanë përfunduar shkollën e mesme, por mendojnë se është tepër vonë për ta për të studiuar tani. Një tjetër pengesë për reregjistrimin në nivel individual dhe në nivel komuniteti është gjendja financiare e të mbijetuarit(ës). Ata që jetojnë në komunitet (jo në një strehëz) duhet të paguajnë qiranë dhe shërbimet e tjera bazë. Për rrjedhojë, ata mund të kenë përparësi gjetjen e punës dhe jo arsimimin. Përsa i përket kujdesit shëndetësor, ka pak qendra trajtimi për abuzimin me substancat dhe pak shërbime të specializuara të kujdesit shëndetësor mendor në Shqipëri, veçanërisht në zonat rurale, si dhe akoma më pak shërbime të specializuara për fëmijët. Gjithashtu, të mbijetuarit(at) kanë të drejtën e mbështetjes për strehim, megjithëse pak prej tyre kanë qenë në gjendje të kenë akses në bonusin shtetëror të qirasë ose të përfitojnë nga programi special i strehimit. Në fushën e ndihmës ekonomike, vetëm katër të intervistuar (29%) raportuan se kishin marrë ndihmë, duke sugjeruar se ose të mbijetuarit(at) nuk janë në dijeni të ndihmës ekonomike, ose nuk dëshirojnë të aplikojnë për të për shkak të burokracisë, sasisë së vogël të ndihmës ose diskriminimi nga profesionistët e shërbimeve gjatë procesit të aplikimit.

Paragrafët e mëposhtëm theksojnë gjetjet dhe rekomandojnë disa 'hapa pasues' për forcimin e përgjithshëm të mekanizmave të mbështetjes së riintegrimin ekonomik për të mbijetuarit(at) e trafikimit në Shqipëri.

Raporti diskuton mungesën e opsioneve të trajnimit profesional për të mbijetuarit(at) që jetojnë në zonat rurale. **Institucionet e përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore të eksplorojnë opsione për rritjen e pranisë dhe cilësisë së shkollave të formimit profesional dhe qendrave të tjera të trajnimit në zonat rurale të vendit dhe për zgjerimin e programeve të certifikuara të trajnimit nëpër sektorë që ka të ngjarë të punësojnë të mbijetuarit(at).** (p.sh., bujqësia, mikpritja dhe turizmi).

Studimi thekson rëndësinë e mbështetjes së të mbijetuarve për të zgjedhur trajnimet e tyre profesionale dhe punësimin në të ardhmen. Profesionistët e shërbimeve **duhet të sigurojnë që të mbijetuarit(at) të marrin informacion të plotë në lidhje me aftësimin profesional dhe opsionet e punësimit që kanë në dispozicion, dhe të fuqizohen të zgjedhin trajnimet dhe punësimin e tyre të preferuar.**

Studimi hulumtoi vlerën e praktikave profesionale si një rrugë e rëndësishme drejt punësimit. **Institucionet përkatëse mund të krijojnë dhe të ndajnë bazat e të dhënave të kompanive që mund të punësojnë të mbijetuarit(at) si praktikantë.** Ata që shprehin interes për të punësuar të mbijetuarit(at) si praktikantë duhet të verifikohen për të garantuar sigurinë e të mbijetuarve.

Studimi thekson se disa të mbijetuar duan të fillojnë biznesin e tyre, por nuk kanë trajnim e përshtatshëm të biznesit dhe kapital fillestar për ta bërë këtë. Institucionet përkatëse mund të bashkëpunojnë **për të forcuar mekanizmat e trajnimit për vetëpunësimin e të mbijetuarit(at).** Programet e trajnimit mund të zhvillohen në bashkëpunim me subjektet e sektorit privat; programe të tilla trajnimi mund të ofrojnë njohuri dhe aftësi për rëndësinë e vlerësimeve të tregut, zhvillimin e planeve të biznesit, menaxhimin e buxheteve dhe marketingun. Gjithashtu e rëndësishme është që të mbijetuarve t'u sigurohet **kapital fillestar** për të mbështetur veten gjatë fazës së hershme të hapjes të biznesit të tyre. Një kapital i tillë fillestar mund të vijë në formën e një kredie me një normë interesi shumë të ulët, ose edhe pa interes.

Është e rëndësishme që të mbijetuarit(at) **të vazhdojnë të marrin mbështetje për riintegrim nga profesionistët e shërbimeve pasi ata të fillojnë një punë të re, ose të nisin një biznes të ri. Cikli këshillimor duhet të vazhdojë në kuadër afatgjatë,** të paktën një vit pas fillimit të punës, ose nisjes së një biznesi të ri. Mbështetja për aftësitë e jetës dhe menaxhimin e biznesit duhet të jetë e vazhdueshme, së bashku me këshillimin psikosocial.

Studimi thekson gjithashtu se riintegrimi ekonomik i të mbijetuarve kërkon akses cilësor dhe të qëndrueshëm në shërbime të tjera mbështetëse, të tilla si arsimit, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe ndihma ekonomike. **Investimi për forcimin e sistemeve të riintegritit ekonomik për të mbijetuarit(at) e trafikimit kërkon forcimin e infrastrukturës së arsimit, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe shërbimeve të tjera kryesore sociale, të tilla si kujdesi ndaj fëmijëve.** Këto investime kërkojnë shkallëzimin e reformave në secilën prej këtyre fushave, të materializuara në rritjen e financimit në nivel vendor për të rritur disponueshmërinë e shërbimeve. Shqipëria duhet gjithashtu të vazhdojë të shtojë përpjekjet **për të forcuar sistemin e saj të kujdesit të shëndetit mendor.** Aktualisht, të mbijetuarit(at) që vuajnë nga çrregullime akute të shëndetit mendor, të tilla si trauma të rënda ose varësia, nuk mund të marrin shërbimet e duhura, veçanërisht në zonat rurale. Ka të ngjarë që riintegrimi i tyre ekonomik të pengohet, për shkak të mungesës së kujdesit të specializuar për të mbështetur rimëkëmbjen dhe riintegrimin e tyre të përgjithshëm. Gjithashtu në lidhje me këtë, **institucionet përkatëse të përfshira në luftën kundër trafikimit mund të bashkëpunojnë për të siguruar që politika ekzistuese për ofrimin e shërbimeve të zbatohet në kohën e duhur dhe që të mbijetuarit(at) të ndërjegjësohen për të drejtat e tyre sipas legjislacionit dhe politikave ekzistuese.**

Studimi thekson gjithashtu rëndësinë e **ofrimit të riintegritit ekonomik dhe shërbimeve të tjera, jo vetëm për të mbijetuarit(at) e trafikimit, por edhe për anëtarët e familjeve të tyre.** Profesionistët përkatës duhet të zgjerojnë programet e mbështetjes për familjet në vështirësi social-ekonomike, me qëllim që në radhë të parë të parandalohet trafikimi, si dhe ciklet e rritjes. Një mbështetje e tillë për familjet duhet të përfshijë mbështetjen për aksesin në arsim, kujdes shëndetësor, strehim dhe ndihmë ekonomike dhe të jetë afatgjatë.



Raporti përmend në shumë pika problemin, në nivel komuniteti dhe shoqërie, të stigmës ndaj të mbijetuarve të trafikimit. Përpjekjet për të rritur disponueshmërinë e shërbimeve për të mbijetuarit(at) e trafikimit në Shqipëri duhet të bëhen paralelisht me përpjekjet për të ulur qëndrimet negative ndaj të mbijetuarve midis disa profesionistëve të shërbimeve. Adresimi i stigmës në Shqipëri kërkon rritjen e ndërgjegjësimit për trafikimin e qenieve njerëzore tek të gjithë qytetarët, përfshirë profesionistët e shërbimeve. Për të arritur këtë, **institucionet përkatëse e përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri mund të zhvillojnë një program mbarëkombëtar për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin mbi trafikimin e qenieve njerëzore**, duke synuar zvogëlimin e qëndrimeve diskriminuese ndaj të mbijetuarve. Zvogëlimi i stigmës mes profesionistëve të sektorëve të ndryshëm nëpërmjet një programi të tillë mund të kontribuojë për përmirësimin e aksesit të të mbijetuarve në shërbimet e riintegritit ekonomik.

Raporti thekson se mbështetja cilësore dhe e qëndrueshme për riintegrimin ekonomik për të mbijetuarit(at) kërkon që aktorët dhe shërbimet përkatëse të jenë të lidhura. Në këtë mënyrë, **rritja e përpjekjeve të institucioneve përkatëse dhe sektorit privat për të bashkëpunuar është me vlerë**. Mund të ketë vlerë rishikimi i të gjithë infrastrukturës së koordinimit me qëllim që: të zgjerohet funksioni i Mekanizmit Kombëtar të Referimit për të përfshirë një koordinim më të gjerë të agjencive kundër trafikimit të qenieve njerëzore; të zgjerohen strukturat ekzistuese, të tilla si komitetet rajonale kundër trafikimit, për të koordinuar më mirë aspektet e mbështetjes për riintegrimin e të mbijetuarve, duke përfshirë riintegrimin ekonomik, dhe që të krijohet lidhje me aktorët përkatës të sektorit privat; dhe të futen mekanizma koordinues në nivel bashkie.

Studimi nënvizon gjithashtu se **riintegrimi ekonomik nuk duhet parë i veçuar nga integrimi social. Ofrimi i shërbimeve brenda kornizave të integritit ekonomik dhe social duhet të ndërlihet dhe të përkthehet në ofrim efektiv të shërbimeve** nga të gjithë profesionistët përkatës të shërbimeve në të gjithë sektorët. **Për më tepër, ofrimi i shërbimit duhet të jetë i orientuar nga të mbijetuarit(at)**. Ndërkohë, rritja e ndërtimit të kapaciteteve të të gjithë profesionistëve të shërbimeve duhet të forcohet, dhe ata të ndërgjegjësohen për rëndësinë e ofrimit të shërbimeve të fokusuar/përqendruara te të mbijetuarit(at) dhe rëndësinë e ciklit afatgjatë këshillues që i duhet ofruar atyre.

Së fundi, nevojiten më shumë kërkime për të kuptuar sfidat dhe mundësitë për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit. Është me vlerë që institucionet përkatëse e përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore të bëjnë një hartëzim të legjislacionit dhe politikave kombëtare për riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit në Shqipëri dhe studime se si legjislacioni dhe politikat përkthehen në praktikë. Gjetjet mund të shërbejnë për identifikimin e mangësive të legjislacionit, politikave dhe praktikave. Studimet cilësore mund të eksplorojnë se si mund të duket riintegrimi ekonomik afatgjatë në kontekstin e Shqipërisë. Kjo mund të arrihet nëpërmjet kërkimeve që vëzhgojnë në mënyrë të përsëritur të njëjtin grup të synuar, të cilat përfshijnë intervista me të mbijetuarit(at) e trafikimit në një shtrirje të gjatë kohore. Një kërkim i tillë, i kryer gjatë të paktën një periudhe pesëvjeçare, mund të sigurojë njohuri të vlefshme për rezultatet e përpjekjeve për riintegrim ekonomik, të identifikojë fushat që kërkojnë fuqizim të mëtejshëm dhe të nxisë ofrimin e shërbimeve të bazuar te nevoja në të ardhmen. Studimet cilësore mund të trajtojnë gjithashtu pyetje kërkimore mbi riintegrimin ekonomik të të mbijetuarve meshkuj. Ky studim përfshin vetëm përvojat e një të mbijetuarit mashkull lidhur me aksesin e mbështetjes për riintegrimin ekonomik në Shqipëri. Kërkimet e ardhshme mund të eksplorojnë përvojat e të mbijetuarve meshkuj lidhur me aksesin në trajnime profesionale, punësim, mbështetje për hapjen e një biznesi dhe ndihmë ekonomike. Studime të ngjashme mund të kryhen edhe me të mbijetuarit(at) LGBTQI+, dhe të mbijetuar nga pakicat kombëtare, për të kuptuar sfidat konkrete me të cilat përballen ata për të pasur akses në mbështetjen e riintegritit ekonomik. Studimet mund të përqendrohen gjithashtu te sfidat dhe mundësitë për ofrimin e shërbimeve të veçanta mbështetëse, siç është ndihma juridike, e cila nuk u diskutua në këtë raport. Ndërsa parashikohet që aksesin te shërbimet kryesore shtetërore në Shqipëri, në të ardhmen e afërt, do të kalojë online, studimet duhet të eksplorojnë gjithashtu sfidat konkrete me të cilat përballen të mbijetuarit(at) për të pasur akses në këto shërbime.

# Bibliografia

- Beyer, Kirsten, Wallis, Anne B. dhe Hamberger, L. Kevin, ("Mjedisi i lagjes dhe dhuna e partnerit intim: një rishikim sistematik" Trauma, Dhuna dhe Abuzimi), 'Neighbourhood environment and intimate partner violence: A systematic review'. Trauma, Violence and Abuse, vëll. 16 nr. 1, Epub dhjetor 2013, f. 16–47.
- Cecchet, Stacy J., dhe John Thoburn, ("Përvoja psikologjike e trafikimit seksual të fëmijëve dhe adoleshentëve në Shtetet e Bashkuara: Trauma dhe qëndrueshmëria tek të mbijetuarit." (*The psychological experience of child and adolescent sex trafficking in the United States: Trauma and resilience in survivors*). Trauma Psikologjike: Teori, Hulimtim, Praktikë dhe Politika, vol. 6 nr. 5, 2014, f. 482–493.
- Këshilli i Evropës, "Konventa Evropiane për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore." Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës - Nr. 197, Varshavë, maj 2005, f. 19.
- Të Ndryshëm dhe të Barabartë, (Të biesh nëpër të çara! Trafikimi i meshkujve dhe djemve në Shqipëri) *'Falling through the cracks! The trafficking of men and boys in Albania'*. Tiranë, janar 2015. F. 72.
- Të ndryshëm dhe të barabartë, "Kërkim mbi aftësitë dhe mundësitë e tregut lokal të punës për të mbështetur fuqizimin ekonomik të të mbijetuarve të trafikimit dhe dhunës në familje në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë." nëntor 2018, f. 40.
- Grupi i Ekspertëve për Veprimin Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, (Raporti i Vlerësimit: Shqipëri. Raundi i tretë i vlerësimit: Qasja në drejtësi dhe mjete efektive juridike për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore). *'Evaluation report: Albania. Third evaluation round: Access to justice and effective remedies for victims of trafficking in human beings'*. GRETA, dhjetor 2020, f. 48.
- INSTAT, Anketa tremujore e forcave të punës – 2022" (në shqip). Qershor 2022, f. 8.
- Organizata Ndërkombëtare e Punës, Riintegrimi socio-ekonomik i ish-luftëtarëve, *'Socio-Economic Reintegration of Ex-Combatants'*. ILO, Gjenevë, 2010, f. 172.
- Organizata Ndërkombëtare e Punës, Udhëzime globale për riintegrimin ekonomik të viktimave të punës së detyruar përmes qasjeve të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit të aftësive, *'Global guidelines on the economic reintegration of victims of forced labour through lifelong learning and skills development approaches'*. ILO, Gjenevë, nëntor 2020, f. 106.
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Udhëzime për të ndihmuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Rajonin e Afrikës Lindore, Guidelines for assisting victims of human trafficking in the East Africa Region IOM, Gjenevë, 2011, f. 58.
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Glosar i Migracionit. IOM, Gjenevë, 2019, f. 237.
- Mandro, A. dhe Rusi, N., 'Monitorimi i Ligjit 22/2018 Për Strehimin Social nga njësitë e qeverisjes vendore'. UNWOMEN, BE, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, 2021.
- Ministria e Shëndetësisë, 'Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013–2022' (në shqip). shkurt 2013, f. 27.
- Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), "Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore;" *'Recommended principles and guidelines on human rights and human trafficking'* 2002, f. 15.
- Pardeck, John, "Një qasje ekologjike për praktikën e punës sociale." Revista e Sociologjisë dhe Mirëqenies Sociale, vëll. 15 nr. 2, 1998, f. 133–142.
- Ramaj, Klea, 'Pasojat e trafikimit të qenieve njerëzore: Eksplorimi i sfidave të kthimit, rehabilitimit dhe riintegritimit të viktimave shqiptare. Gazeta e Trafikimit të Njerëzve, 2021, f. 22.
- Sanchez, Rosario V., and Dula Pacquiao, *'An Ecological Approach toward the Prevention and Care of Victims of Domestic Minor Sex Trafficking'*. Journal of Forensic Nursing, vol. 14 no. 2, 2018, pp. 98–105.
- Surtees, Rebecca, ("Ri/integrimi i personave të trafikuar: mbështetja për fuqizimin ekonomik. Punimi me numër 4") *'Re/integration of trafficked persons: supporting economic empowerment. Issue paper No. 4'*. Fondacioni Mbreti Baudouin, Bruksel, Instituti NEXUS, Uashington, dhjetor 2012, f. 86.
- Tahiraj, Enkelejda, "Kuptimi i trafikimit të vajzave dhe grave nga Shqipëria." Programi Shpresa, korrik 2017.
- Kombet e Bashkuara, "Protokolli për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional;" *'Protocol to Prevent, Suppress and Punish Trafficking in Persons Especially Women and Children, supplementing the United Nations Convention against Transnational Organized Crime'*. nëntor 2000.
- Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, 2021, (Raporti i Trafikimit të Personave 2021: Shqipëria), *'Trafficking in persons report 2021: Albania'*. 2021.
- World Health Organization, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Atlasi i Shëndetit Mendor 2017 (Mental Health Atlas 2017), Profili i Shtetit Anëtar, Shqipëria, janar 2017.



